



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipal Kaçanik

Kuvendi i Komunës

-Kryesuesi i Kuvendit-

**01Nr. 060/01-27044/24**  
**Kaçanik, 18.10.2024**

## **FTESË PËR MBLEDHJE**

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 30.10.2024 (e mërkurë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli

---

Në mbledhjen e X (dhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 30.10.2024 do të shqyrtohet ky:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti nëntëmujor financiar për periudhën, Janar-Shtator 2024;
3. Raporti i Përformancës komunale për vitin 2023;
4. Informatë për përfundimin e Vitit Shkollor, 2023-2024;
5. Propozim Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve’ Sh. A. Kaçanik;
6. Kërkesa e MMPHI 6483-2/24 për Rishqyrtimin e Vendimit për miratimin e Planit të Veprimit në Mjedis me veprim klimatik i komunës së Kaçanikut 2024-2029 i datës 30.09.2024.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal of Kacanik**

**01Nr.060/01-23705/24**  
**Kaçanik, 30.09.2024**

### **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **IX (nëntë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 30.09 2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 25 anëtarë, në ndërkohë arriti anëtari, Betim Shala, ndërsa gjatë pikës së dytë, Agim Çaka.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Sali Malsiu-DSHMS, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Makfire Malsiu, Fatlume Guri-Selimi, Mavije Murseli.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, 2 anëtarë për momentin nuk janë, Betim Shala dhe Agim Çaka. Agim Çaka me ka njoftuar se vonohet pak. E hapi mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 30.09.2024, me këtë:

#### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027;
3. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e vendimit 01 nr. 60/01-38152/21 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe vendimit 01 nr. 60/01-14084/24 për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e këtij komiteti;
4. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar 01Nr. 320/01-2238/24 të datës 10.09.2024 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet breshëri në territorin e komunës së Kaçanikut, në fshatin Duraj - Gabrricë;
5. Plani i Veprimt në Mjedis, me veprim klimatik;
6. Draft-Plani Komunal për transport lokal publik të udhëtarëve, 2024-2028;
7. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2024;
8. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2024-2025 në komunën e Kaçaniku;
9. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 400/01-6738/24 të datës 29.03.2024 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të Parcelave në Zonën Kadastrale Kaçanik dhe Gajre;

10. Kërkesa për Dorëheqje e anëtarit të KK, Rustem Zenuni, nga Komisioni komunal i aksionarëve NPK” stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik;
11. Kërkesa për Dorëheqje e anëtarit të KK, Rustem Zenuni, nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut.
12. Propozim Vendim Për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore deri në 5% sipas Buxhetit të vitit 2024.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

### **Aprovoj**

#### **Rendin e punës prej 12 pikave.**

1. Arovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Shprehi shqetësimet për problemet në transmetimin e drejtpërdrejtë të seancës së KK, për mungesën e fokusimit të folësit gjatë fjalimit në seancë. Ky problem ka ndikuar drejtpërdrejtë në mendësinë e qytetarëve, për të kuptuar dhe ndjekur diskutimet në KK. Kjo duhet të rregullohet, ashtu që nga kjo seancë me ngritur transparencën dhe llogaridhënie para qytetarëve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kërkoj falje nëse incizimi ka qenë ashtu, meqë këto janë në mënyrë automatike, kamera vet fokusohet të folësi. Janë çështje teknike që mund të rregullohen.

**z. Agim Mani:** Në fjalimin tim citohet qartë thënia ime, që ka kërkuar falje drejtori i DBF Bahri Selimi dhe unë e kam pranuar faljen. Ndërkaq në procesverbal nuk shkruan se cila është arsyeja që drejtori ka kërkuar falje? Nuk është shënuar thënia e drejtorit të DBF, që i ka thënë anëtarit të KK “Mbylle gojën”. Nëse bëhet ky plotësim, atëherë do të votoj “Për” miratimin e procesverbalit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në rregull, ky plotësim bëhet kjo, së është evidente e dukshme.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Në procesverbal, debatin që e kam pasur me kryesuesin e KK, është shënuar vetëm pjesa ime, por jo edhe e kryesuesit. A jeni i kënaqur ju kryesues me procesverbalin, që me ndryshuar dhe plotësuar apo nuk e keni lexuar, se nuk e di çfarë kuptimi ka me qenë vetëm pjesa e diskutimit tim, se nuk dihet për çka kam folur.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në procesverbal nuk mund të shkruhet çdo gjë që diskutohet në KK. Sekretaria i merr çështjet thelbësore që duhet të shkruhen. Çështja se a janë shënuar fjalët e mia, këtë mund ta kërkoj unë. Vërejtje tjera nuk ka, atëherë me këto vërejtje e shtroj në votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar të KK dhe i njëjti u aprovua me njëzëri. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi së kuvendi i Komunës me vërejtje e,

### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së VIII (tetë) të Kuvendit të Komunës, të datës 05.09.2024/  
Lënda: 01Nr. 60/01-20699/24.**

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** Kam disa shqetësime, njëri prej tyre i përsëritur.

1. Me datën 28.09.2023 ka qenë e propozuar pika për rialokimin e mjeteve për parkingun e komunës. Kërkesa ka qenë e drejtorit me u hequr pika nga rendi i ditës, për arsyet që i keni pasur. Sot pas një viti, a ka kush që jep përgjigje për katrahurën që po shohim para objektit të komunës.

2. Në një mbledhje të KK, në muajin maj apo qershor, kam kërkuar që të vendosën policët e shtrirë në rrugë, në qytet dhe në vendbanime tjera të komunës. Këtë kërkesë po e përsërisë

edhe tani, pasi që shqetësimi vjen nga qytetarët e komunës. Nëse është vështirë me u identifikuar lokalitetet se ku duhet të vendosën pengesat në rrugë, ndoshta kishte qenë mirë me pasur një debat publik me qytetarët e komunës, me qenë prezentë edhe nga policia. Përgjigjen e kam marrë prej drejtorit, por rezultat nuk ka në praktikë. Shpejtësia e automjeteve po zhvillohet e madhe dhe paraqet rrezik për jetë. Kostoja nuk është e madhe, por ka kosto shpëtimi i jetës së njeriut.

**z. Naim Beça:** Kam një kërkesë dhe një shtjellim:

1. Kohëve të fundit është vërejtur një prani e madhe e qeneve endacak në qytetin e Kaçanikut. Kërkoj të merren masa, pasi disa drita në Kaçanik janë prishur, dhe prania e qeneve endacak paraqet rrezik për fëmijë. Të merren veprime të nevojshme sa nuk ka ndodhur ndonjë fatkeqësi.

2. Shtjellimi i një situatë në komunën tonë: Me 7 shtator 2024, me 7 shtator para 34 viteve Kosova është shpallë Republikë me Kushtetutën e saj të aprovuar, që i ka paraprirë Deklarata kushtetuese e 2 korrikut 1990, duke pasur me referendumin për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, ku kanë marrë pjesë 98% e popullatës dhe janë shprehur për referendumin. Në vitin e kaluar 2023, në mbledhjen e tetorit keni thënë se, kemi gabuar që nuk i kemi pritur delegatët e Kuvendit të Kosovës, në Kaçanik. Delegatët e KK unë i kam pa me 7 shtator 2024 duke u sjellë në Kaçanik. Me thënë të drejtën, me ka ardhur marre që jam anëtar i KK. Pas nja 20 viteve kemi me harruar edhe UÇK-në. A jemi ne ata fëmijë të atyre baballarëve që kanë bërë vepra patriotike, që e kanë shpallë Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, ku në atë kohë asnjë komunë e Kosovës nuk e ka marrë atë barrë, kushtetuta e Kosovës është shpallë në Kaçanik. Çdo vit e harrojmë 7 shtatorin. Ata ish delegatë duhet t'i nderojmë se paku me një koktell sa janë gjallë, me një mirëseardhje në komunë. E takova një prej tyre, ankesat e tyre ishin të arsyeshme, por nuk i tregova se jam anëtar i KK. Kërkoj që vitin vijues të hynë në procedurë të komunës së Kaçanikut, të formohet një komision dhe të kujtojmë 7 shtatorin, shpalljen e Kushtetutës së Kaçanikut të vitit 1990 nga delegatët e asaj kohe. Kjo është moto e jonë, vetëm një datë e kemi në Kaçanik, ajo është në librat e historisë, që e shkruajnë edhe amerikanët, ndërkaq në vet këtu si Kaçanik jemi duke i humbur vlerat tona. Nëse kështu vazhdon, pas një kohe mund të humbet edhe beteja e Ivajës dhe betejat tjera që ekzistojnë, për të cilat ka shumë sakrificë.

**znj. Arta Avdiu:** Kam 2 pyetje për DSHPE, z. Ramadush Osmani: 1. I bashkëngjitëm shqetësimeve të kolegut për çështjen e qeneve endacak, se me preku jo vetëm mua si nënë por edhe çdo qytetarë në rrethin tonë. Shtimi i qeneve endacak, çdo ditë e me tepër në çdo cep të çdo lagjeje, edhe këtë vit po ngel një problem madhor i qytetarëve e sidomos të fëmijëve, duke cenuar direkt jetën e tyre. Çfarë masa do të merrni, marrë parasysh faktin se tani fillon stina e dimrit, me çka rreziku nga qentë endacak do të jetë edhe me i madh?

2. Në mbledhjen e fundit të Komitetit për Komunitete, si temë u diskutua çështja e sigurisë në vendin tonë. Një shqetësim që u ngrit nga ne - anëtarët të këtij komiteti, por edhe nga komandanti i stacioni i policisë, ishte: Mosfunksionimi i kamerave të sigurisë në qytet. Për shkak të keq menaxhimit komunal këto kamera nuk janë në funksion, me çka funksionimi i tyre do të lehtësonte punën e sigurisë të vendit tonë. Pse nuk janë në funksion kamerat e sigurisë në qytet, që një vit?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse e ka ngritur komandanti këtë pyetje, po me vjen shumë interesant, se komandanti i menaxhon kamerat e sigurisë, se ne nuk e dimë se cilat kamera janë prishur.

**znj. Arta Avdiu:** Pikërisht komandanti ishte ai që kur e pyetëm ne se çfarë mundemi me ngritur ne si shqetësim në KK, ai fajin e hedhin tek ju. Është incizimi i mbledhjes.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk po dyshoj se e ka ngritur si temë, por e ka ngritur gabimisht.

**Kryetari i komunës –Besim Ilazi:** Komandantin e policisë është dashur me pyetur: Aset i kujt janë kamerat e sigurisë.

**z. Ekrem Livoreka:** Ne e kemi bërë këtë pyetje dhe i kemi thënë se ju po ia hedhin fajin komunës, komuna juve. Komandanti i policisë theksoj se, menaxhimin e kemi ne, ndërkaq blerjen dhe vendosjen e kamerave të sigurisë e ka komuna. Përgjigjen që ma ka dhënë drejtori, e ka specifikuar se kush menaxhon me kamerat e sigurisë.

**znj. Arta Avdiu:** Komandanti i policisë theksoj se, komuna gjatë punimeve që i ka bërë në rrugë, i ka prishë kamerat e sigurisë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk është ashtu, po ne jse nuk mundemi tani me e trilluar këtë temë.

**z. Agim Mani:** Pyetjet të cilat parashtrohen, duhet me u marrë seriozisht me u përgjigjur. Pavarësisht konfuzionit që e keni ju si ekzekutiv- kryetarit të KKSB, komandantit të policisë që nuk keni d akordime në mes veti, kjo u shtrua si pyetje që tani kryetari i komunës në bashkëpunim me komandantin e policisë të d akordohen për çështjen e menaxhimit të kamerave dhe mirëmbajtjen e tyre. Çështja e kamerave të sigurisë ka kohë që është problem, ka pasur rekomandime në KKSB, por asnjëherë nuk janë zbatuar. Pyetjet të cilat i ngritëm ne janë të qytetarëve, përgjigjet, llogaridhënia është e ekzekutivit, por nuk po jepni llogari as para neve si anëtarë të KK e as para qytetarëve. Kjo është shqetësuese. Pyetjet të cilat i kemi ngritur në mbledhjen e kaluar, nuk kemi marrë përgjigje. Atëherë, cili është kuptimi me ngritur pyetje? Meqë nuk po jepni përgjigje me shkrim, atëherë unë tani kërkoj një pyetje direkt nga kryetari i komunës: Si e keni trajtuar objektin e banimit social, i cili sipas juve është i përfshirë në krime ekonomike? A ka ndonjë konfirmim zyrtar nga Prokuroria speciale për këtë objekt? Si e aplikoni shpalljen e aplikimeve për qytetarë që të strehohen në këtë objekt, marrë parasysh situatën aktuale? Këto përgjigje dua t' me epën direkt, pasi ju keni informata, se nëse nuk keni informata, besoj se keni bërë shumë gabim që keni hapur aplikime për qytetarë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për përgjigjet në pyetje, është një rregull, të cilën jemi të obliguar me zbatuar të gjithë. Ndonjëherë mund të mos ketë përgjigje për ndonjë pyetje, natyra e përgjigjes është me shkrim. Ndërkaq, pajtohem nëse ngitni çështjen për pyetje të cilat nuk iu kanë kthyer përgjigje, se keni të drejtë në atë drejtim.

**z. Bashkim Luma:** Kam një kërkesë nga banorët e f. Gllloboçicë, Lagjja e Re, kanë kërkuar që kjo rrugë të regjistrohet si rrugë zyrtare, por fatkeqësisht nuk është marrë parasysh ende. Tabela që është në mbishkrimin në f. Gllloboçicë, duhet të korrigjohet dhe të ndryshohet vendndodhja, se f. Gllloboçicë fillon nga me lartë, e jo nga aty ku është vendosur shenja.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** 1. Po ndërlihem me shqetësimin e Agimit për çështjen e përgjigjeve në pyetje dhe kërkesa, se dy pyetje që i ngrita në mbledhjen e fundit, për njërin me ka ardhur përgjigja nga DA, ndërsa tjetra ishte për kryetarin. Nuk e di kryetar: A ta ka përcjellë nënkryetari pyetjen se ju nuk ishit prezentë në atë mbledhje, se përgjigje në pyetje nuk kam marrë? Kjo ndikon shumë keq të ne anëtarët e KK, se shqetësimet e qytetarëve ne i drejtojmë direkt juve. Ju jeni ai që duhet me u përgjigjur në pyetjet tona që i adresojmë.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Me është dukur e pa arsyeshme pyetja, nuk kam ditur si me u përgjigjur.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Nëse pyetja ime të është dukur e paarsyeshme, është dashur me cekur. A mundeni me kthyer përgjigjen me shkrim, me thënë se kërkesa e juaj me është dukur e paarsyeshme me u përgjigjur? Unë kërkesat i kam nga qytetarët.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Me është dukur e paarsyeshme, se një praktikë që udhëhiqet që 20 vjet, ju doni me ndryshuar. Thjeshtë, do të kthej me shkrim përgjigjen.

**znj. Kadrije Lika-Troni: 2.** Kërkesa e dytë është për DSHPE: Mungesa e pengesave në rrugë për me penguar shpejtësinë e automjeteve, ashtu siç e ceku edhe parafolësja ime, sidomos në rrugën "Qamil Ilazi", ku trotuari është pa asnjë kriter standardi, ku nxënësit e kanë të vështirë kalimin dhe janë të rrezikuar nga shpejtësia e automjeteve. Gjithashtu edhe vazhdimi i rrugës "Sali Bajra" aty të shkolla fillore, trotuari është i mbuluar nën stop me vetura, sidomos në kohën kur nxënësit frekuentojnë për në shkollë. Kërkoj nga drejtori të vendosë pengesa, që me parandaluar krijimin e ndonjë rreziku për nxënësit e shkollës.

**znj. Ardita Rrahmani:** Meqë jemi gati në përfundim të mandatit, e ngriti si shqetësim apo propozim, se po ka kërkesa ripërsëritura, të ngritura nga unë apo nga kolegët e mi, të cilat pika janë ngritur me herët dhe të njëjtat ri adresohen përsëri. E kuptoj se jemi në vit zgjedhor, por për mua personalisht, kjo është thyerje e inteligjencës. Nëse ri përsëritet e njëjta kërkesë, ndërkaq në anën tjetër edhe ekzekutivi nuk ka asgjë konkrete dhe na detyron në njëfarë mënyre me u ripërsëritur kërkesat, por me marrë atributet e dikujt tjetër, të cilat nuk i takojnë, për mua kjo është thyerje e inteligjencës.

**z. Selajdin Troni:** Kam një kërkesë nga lagjja koraqi e f. Kovaqec, rruga "Raif Koraqi": Të bëhet rehabilitimi dhe shtrimi i rrugës si dhe rregullimi i kanalit për largimin e ujit nga rruga, sepse si rezultat i ujit, po prishet rruga. Gjithashtu të shqyrtohen mundësitë buxhetore për ndriçimin publik të kësaj rruge.

**z. Agim Mani:** Kërkoj falje që e mora fjalën dy herë të e njëjta pyetje, por desha të elaboroj një sqarim të kryetarit, të cilën fillimisht unë e theksova se, ne po bëjmë pyetje, ndërkaq nuk po marrim përgjigje. Kryetari e pranoj se për kërkesat që nuk janë të arsyeshme, përgjigjet nuk epen. Të gjitha përgjigjet që nuk janë dhënë deri me tani në pyetjet e ngritura, për kryetarin po dalin se kanë qenë të parëndësishme.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Sot jam këtu për të ndarë një situatë të paprecedentë dhe të papranueshme që me preku jo vetëm mua personalisht, por çdo qytetarë të këtij vendi që beson në drejtësi, transparencë dhe liri të shprehjes. Në mbledhjen e fundit të këtij KK, unë ngrita shqetësim tim lidhur me subvencionet komunale. Mirëpo, ajo që ndodhi pas këtij veprimi, është e tmerrshme dhe e papranueshme në një shoqëri demokratike. Me 7 shtator mora një telefonatë dhe një mesazh kërcënues nga drejtoresha e kulturës e komunës tonë. Fillimisht mendova se është për ndonjë kontakt për ndonjë aktivitet kulturor që lidhet me përvjetorin e komunës së Kaçanikut, por në vend të kësaj e nderuara drejtoreshë, ajo nxori këtë ditë për t' me kërcënuar personalisht. Jo vetëm mua që me kërcënoj, por me tha se do të vijë në shtëpinë time me burrin e saj dhe do të kërkonte llogari nga prindërit e mi. Imagjinoni për një moment të vjen një kërcënim nga një grua për një vajzë. Sa shqetësuese është kur pranojmë kërcënime nga gratë, pikërisht nga një zyrtare e lartë e komunës, përgjegjëse për kulturën dhe përfaqësuese e qytetarëve, përdorë fuqinë e saj për t' me kërcënuar, një qytetare e cila kërkon vetëm drejtësi dhe transparencë. Çfarë mesazhi po i dërgojmë shoqërisë? Çfarë mesazhi po iu dërgojmë brezave të ri? Kjo është një përpjekje e qartë për t' me frikësuar dhe për t' me heshtur dhe për t' me ndaluar që të vazhdoj të kërkoj llogaridhënie. Këtë ta dini të gjithë: Unë nuk do të heshtë sot dhe asnjëherë tjetër. Drejtoresha nuk e di a është këtu, kërcënimet të unë nuk iu shitën, unë nuk do të ndaloj asnjëherë me u shprehur.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtoresha është këtu prezentë në mbledhje. Për çështjen e mesazheve kërcënuese, janë organet që merren me këtë punë. Mirë që e ngrite si shqetësim në KK, nuk është mirë me pasur raste të tilla, por çështja është se për kërcënime të tilla janë organet tjera që merren me këtë punë. Mua me vjen keq, por ne nuk kemi kurrfarë

kompetence me u marrë me këtë punë, janë organet tjera që janë të thirrur me u marrë me këto çështje. Urdhëro Kadrije, por shumë herë e keni marrë fjalën:

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Kryesues me fal, por kjo me ka shqetësuar mua si grua dhe si kolege, kur kërcënimi vjen nga një drejtoreshë e ekzekutivit. Me intereson të di: Çfarë masash do të merr kryetari i komunës? A keni qenë i informuar apo jo për këtë çështje si kryetar -menaxher i drejtorëve? Të lutem merri masat e nevojshme të cilat ekzistojnë. Nuk lejohet fjala e lirë me u kërcënuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E qartë këtë që po e thoni, por përderisa nuk kemi të konfirmuar prej një organi, kjo është detyrim i secilit. Ka organe të cilat e konfirmojnë dhe e detyrojnë qytetarin.

**znj. Ernesta Krasniqi:** E shpërndau letër mesazhin e Hafize Sallahi kryetarit dhe disa anëtarëve të KK, ndërkaq e parashtroj pyetje kryetarit: A jeni të kënaqur me drejtorët e juaj?

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Unë nuk jam gjyqtarë këtu.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtoresha është këtu, mundet me marrë fjalën.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Nuk po e shoh se është kërcënim. Lë të merr fjalën drejtoresha.

**z. Selajdin Troni:** Jemi në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave. Çdo anëtarë i KK që ka pyetje dhe kërkesa mundet me marrë fjalën njëherë dhe me i ngritur të gjitha kërkesat sa i ka, pavarësisht numrit të tyre. Unë nëse e marrë fjalën, i kam fjala vjen 10 kërkesa, i ngriti të gjitha përnjëherë, e jo me marrë fjalën disa herë, se po zgjatet debati.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Selajdin, pavarësisht se jemi të pyetjet dhe kërkesat, është një shqetësim që i ka ndodhur anëtares së KK.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Është hera e parë që e mora fjalën.

**znj. Hafize Sallahi:** Unë nuk kam qenë prezentë në mbledhjen e kaluar të KK. Nëse ju (është fjala për Ernesta) e ndien vetën që jeni ofenduar prej një mesazhi, a nuk ishte ofendim ajo që ti e bërë që përmende emrin e të gjitha atyre grave biznismene që i përmende ti në mbledhjen e fundit të KK? A nuk ishin plot e përplot shoqata dhe shteti i Kosovës është ai i cili shpenzoj aq shumë për ti motivuar gratë shqiptare dhe kosovare për t'u marrë me biznes, ti e pe të arsyeshme për me manipuluar me emra privat. Me emrin tim manipulo kur të duash, se është proces politik, por me emrin e një vajze të arsimuar e cila ka hapur një biznes dhe për 2 vite ka arritur me punësuar njerëz dhe ti ia keqpërdorë emrin këtu, pastaj emrin e tjetrës biznismene që ka shtrirë biznesin e vet edhe në rajonin e Maqedonisë dhe i ka mbi 20 gra të punësuar në Kaçanik dhe ti e pe të arsyeshme në KK të degradosh me emrin e atyre vajzave. A nuk munde me i përmendur bizneset, por përmende emra, mbi të gjitha publikove edhe në faqen "S'je Kaçanikli" me shkronja të mëdha emrat e atyre biznismeneve, që do të jetë e turpshme,

në vend që t'i motivosh dhe të thuash shqyrr që paska femra biznismene në Kaçanik, ti del dhe degradon emrat e fëmijëve tanë, grave të dikujt, vajzës së dikujt, dhe ajo nuk ishte asgjë sipas teje. A nuk munde të adresosh kritika direkt ndaj meje nëse mendojshe vajza ime apo gruaja e drejtorit të arsimit apo kunata e sekretarëshes së kryetarit që kanë marrë pa të drejtë një subvencion, atëherë do të ishte shumë e mirëpritur dhe përballë atyre bravo, do të mërshe edhe shumë bravo tjera, po ti asnjë qasje në dokumente zyrtare nuk e kërkove, nuk e dite se a e kanë marrë ata subvencionin paligjshëm, përmende emra, vajza ime është 19 vjeçare dhe përmende emra në KK, pse nuk the drejtoresha e kulturës, por Miranda Sallahu. Me çfarë të drejte degradon emrin e fëmijës tim? Unë fëmijët nuk i kam të kyçur në politikë dhe asnjëherë nuk do t'i kyçi, jam vet personalisht. Adreso çfarë duash kritike në drejtim timin, por jo të degradosh emrat e fëmijëve të mi në kuvend komunal, se janë organet nëse mendon



se ka pasur shkelje të procedurës së ndarjes së subvencioneve, dhe i ndjekë penalisht. Po ashtu edhe mua nëse ndihesh e kërcënuar, me ndjekë penalisht, ashtu sikurse unë ty për degradim të emrit të vajzës time. Mbi të gjitha, me e turpshme sesa me i përmendur emrat e biznesmenëve të Kaçanikut, e që nuk janë shumë, e që kanë vajza e gra të punësuar aty. Tjetra, e përmende një biznismene e cila që 30 vite zhvillon biznesin e saj në Kaçanik dhe thoni që ka marrë subvencion, e që për 30 vite Zejnepe Doda nuk ka përfitur nga komuna, por ka nxjerrë plot e përplot nxënëse të cilat punojnë aty këtu në nivel të Kosovës dhe ti del e ia përmendur emrin këtu, e ne duhet me shujtuar. Ti je ajo që ndihesh e kërcënuar, ne jo. Si ndihet vajza ime që veç sa ka filluar një biznes, një vajzë e arsimuar, me ia përmendur emrin. A mundesh me marrë me mend sa është shqetësuar dhe sa ditë të tjera ka mbetur ajo pa gjumë, për shkak se ti e ke degraduar edhe në faqen “Sje Kaçanikli” për 4-5 bravo me i marrë ti në këtë faqe. Pse e përmende emrin, pse përmende emrat e përfituesve. Në muajin mars drejtorja e Kulturës ka ndarë subvencione në vlerë mbi 85 mijë euro, në mesin e përfituesve ka plot zyrtarë dhe aktivist të LVV. Nuk të shkoj asnjëherë mendja me përmend sesi i përfituan ato subvencione, a ishte konflikt interesi apo jo, qenka vetëm për fëmijët tanë konflikt interesi. Përfitues të subvencioneve keni edhe familjar e nderuar, kështu që të kisha lutur prej sot, çfarëdo masa që merr kryetari dhe kushdo tjetër, unë i mirëpres, veç të lutem, nëse prapë përmendet emri i fëmijëve të mi në kuvendin komunal, sinqerisht do të merrem me këtë.

**znj. Ernesta Krasniqi:** E para, turpin që e keni ju, po mundoheni me ma gjuajtur mua, por nuk mundesh. E përmende se është ofendim, por nuk është ofendim, por kërcënim direkt, kryetarit nuk po i duket kërcënim. Me ardhur bashkë me burrin e saj në shtëpinë time me kërkuar llogari prej prindërve të mi, drejtoreshë i kam kaluar të 18-tat. Llogari jap vet, as të prindi, as të motra nuk jap llogari, llogari jap vet. Emrat të cilët i kam përmendur, janë të publikuar në faqen e juaj, emrat nuk i kam marrë fshehtas, janë publikisht. Detyra ime është me ngritur shqetësimin e qytetarëve. Për ty turp të qoftë që kërcënon një vajzë, pikërisht që nesër apo pasnesër vajza juaj mundet me qenë në vendin tim dhe me pranuar kërcënimin nga dikush tjetër. Turp me i madh është kur kryetarit nuk i duket kërcënim, nuk e mbron një qytetare - një asambleiste që ju ka kërcënuar. Nëse vajza e juaj ka mbetur pa gjumë veç se ia kam përmendur emrin, paramendoni si ka mundur me u ndier unë, kur ju me keni kërcënuar se keni me ardhur të prindërit e mi. Shumë mirë e dinë prindërit e mi se çfarë vajze kanë rritur, i di shumë mirë përgjegjësitë dhe jap llogari vet. Hera e para e fundit është që ju mundeni me kërkuar llogari prej prindërve të mijë, prej motrës dhe vëllait. Harroni këtë, i kam kaluar të 18-tat.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ernesta, llogaridhënia dihet se ku jepet, kështu që janë organet si për ju edhe për atë për llogaridhënie.

**znj. Ernesta Krasniqi:** E dëgjuat kryetarin, për mua po thotë se nuk është kërcënim.

**z. Selajdin Troni:** As mua nuk me është dukur kërcënim.

**znj. Ernesta Krasniqi:** As për ty, turp edhe për ty.

**z. Kadri Krivenjeva:** Kuvendi i Komunës e ka një rregullore, të lutem kryesues përmbaju rregullores.

**Kryetari i Komunës:** A e dini kënd e kisha vlerësuar si asambleiste, kur ishe ngritur ti e kishe ngritur shqetësimin, duke përmendur se edhe prindi i juaj është përfitues së bashku me këta, e kisha ndier vetën keq kur përfiton familja.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përfundoj pozicioni i pyetjeve dhe kërkesave, mos të zgjasim diskutimin me tepër të kjo pikë. Mos jepni vlerësime dhe komente, se nuk jemi me dhënë vlerësime dhe komente këtu, kuptoni rolin e juaj këtu. E kemi materialin për çka japim vlerësime, për çështjet tjera, janë organet tjera kompetente. Kalojmë në pikën e dytë:

**z. Agim Mani:** Para se me filluar me këtë pikë, kërkoj 5 min. Pauzë. Pauza u lejua nga kryesuesi i KK.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Kush e kërkoj pauzën?

**znj. Ardita Rrahmani:** Reagoj për çështjen e pauzës, për faktin se duhet me marrë miratimin në KK.

Pas pauzës prej 5 minutave, Kryesuesi i Kuvendit, konstatoj kuorumin, fillimisht ishin 16 anëtarë, ndërkohë arritën edhe anëtarë tjerë, kështu prezentë janë 24 anëtarë. Nuk janë Raif Kasa dhe Naim Beça. U vazhdua me pikën e dytë:

**2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori është këtu, E hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** Lë të jetë kjo vërejtje si kryesues, por edhe për të tjerët, çështja e pauzës duhet me marrë konsultim me anëtarët e KK, se është e drejtë ekskluzive e secilit për votë. Nuk jemi kundër pauzës, por jo me u marrë në formë arbitrare.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Faleminderit, e pranoj vërejtjen.

**z. Agim Mani:** Para se me fol për pikën e dytë, po ndërlidhem me këtë situatë që u krijua tani. Mendoj se Ernesta ka pasur plotësisht të drejtë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos të kthehemi në atë debate më. Jemi në pikën e dytë, buxhetin e komunës për vitin 2025.

**z. Agim Mani:** Ne e dimë rëndësinë e buxhetit, sidomos për investime kapitale, sepse i prekë interesat e qytetarëve, mirëpo ne në këtë buxhet, as nuk jemi thirrur, buxhetin e keni hartuar vet qysh keni ditur dhe dashur. Po kthehemi prapa, lidhur me shqetësimin tonë për kërcënimin e Ernesta Krasniqi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos u ktheni prapa Agim, e kemi shterur atë pikë, kështu të lutëm përmbaju rendit të punës. Mjaft ju kam toleruar. A e vërejtje se pati edhe ankesa për tolerime.

**z. Agim Mani:** Fjala është e lirë, nuk mundeni me penguar fjalën e lirë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E kemi rendin e punës, pauzën ua dhashë pa lejen e të tjerëve. Nëse keni diçka në pikën e 2-të, urdhëroni, nëse jo atëherë ia kaloj fjalën drejtorit të DBF.

**z. Agim Mani:** Është e drejtë e jona dhe e imja personale me shprehur mendimin e lirë. Në shenjë revolte ne LVV do lëshojmë mbledhjen, se nuk po na jepni të drejtë me u shprehur.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Askush nuk të ndali fjalën, ndërkaq është e drejtë e juaja a doni me qëndruar në mbledhje apo jo. Nuk mundeni ju me ardhur këtu me fol çka të doni, se e kemi një rend pune që duhet me iu përmbajtur. Unë ua dhashë 5 minuta pauzë, 10 minuta ju pritëm këtu.

**z. Agim Mani:** Ne u konsultuam, mendimin tonë duhet me dhënë këtu. Në shenjë revolte ne anëtarët e LVV do lëshojmë mbledhjen, se nuk po na jepni të drejtë me u shprehur.

Me këtë rast mbledhjen e lëshuan mbledhjen në formë bojkoti 6 anëtarë të LVV( Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Bashkim Luma, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Burim Shehu), ndërkaq 2 anëtarë të LVV nuk ishin në sallë: Raif Kasa dhe Naim Beça.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pas lëshimit të mbledhjes së anëtarëve të LVV, në sallë janë 18 anëtarë, 12 PDK, 4 LDK 2, AAK. Kuorum ka, u vazhdua me mbledhjen. Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

**z. Bahri Selimi:** Materialin e keni marrë të buxhetit, janë zhvilluar debate publike për përcaktimin e projekteve të përfshira në buxhet, ku kanë qenë të ftuar qytetarët e komunës së Kaçaniku. U përmend më herët se nuk kemi qenë të ftuar në debate publike. Të gjithë qytetarët kanë të ftuar në debate publike, për me u bërë pjesë e buxhetit dhe me i dhënë propozimet e tyre. Pas shterjes se të gjitha diskutimeve publike, është dërguar materiali i buxhetit për diskutim Buxheti për vitin 2025 është në shumë 12,592,239.00€, vlerësimet janë 13,193,668.00€ në vitin 2026 dhe 13,809,572.00€ në vitin 2027. Buxheti shënon ngritje për 5.3% në krahasim me vitin 2024. Është e vogël kjo rritje, për arsye se nuk është marrë për bazë inflacioni që ndodhë vazhdimisht, jemi munduar me shpërndarë në kategori ekonomike me të nevojshme. Shuma 106 mijë kanë shkuar për Paga dhe mëditje, 92 mijë për mallra dhe shërbime, 25 mijë për shpenzime komunale. Subvencionet dhe transferet janë ngritur për 98 mijë euro, 310,822 euro janë ngritur investimet kapitale, kategori kjo që prekë me tepër interesat e qytetarëve. Listën e projekteve kapitale përkundër që e kemi dërguar me herët, pas kërkesës së Agim Mani të mbledhjes se KPF e kemi dërguar edhe një herë për dukshmëri me të mirë. Jemi të hapur për çdo vërejtje apo propozim, jemi në dispozicionin tuaj për përgjigje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Para se me hapur diskutimin, tani e tutje kërkoj që mos të dilni jashtë rendit të ditës. Pika që kalon, me nuk kthehet prapa, kjo është rregull që duhet me iu përmbajtur. Se a duhet ti jepet fjala, ku i them fol për buxhetin, nuk fol, thonë buxhetin e keni bërë ju, jo ne. Kur ftojme diskutim publik, nuk vijnë. Kur është çështja me diskutuar buxhetin, nuk rrinë me diskutuar me thënë pse e keni bërë buxhetin e keq. Arsyeja me dal prej mbledhjes, është se nuk mundën me përballuar këtë buxhet i cili e prekë secilin qytetarë dhe secilin interes publik. Sa është e pranueshme kjo për qytetarët, është treguar që 20 vite. Besoj se me këtë mendësi dhe këtë mentalitet dhe logjikë të qeverisjes se vendimmarrjes çfarë e kanë, do të vazhdojnë edhe 20 vite kështu. E themi publikisht para qytetarëve, edhe pse jemi në transmetim të drejtpërdrejtë, nuk ecet përpara, nuk krijohet mirëqenia e qytetarëve duke lëshuar mbledhjen e mos me qëndruar me diskutuar buxhetin. U theksua se nuk ma dhatë fjalën me diskutua. Këtu nuk mundën me fol çka të doni, por sipas rregullit dhe rendit të punës. Edhe pse jam i vetmi që i kam toleruar me fol çka kanë dashur. Tani e tutje do të ketë rregull dhe rend. E hapi diskutimin:

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Kërkoj një sqarim të ndarja buxhetore të pozicioni, Mallrat dhe shërbimet. Pse është kaq e lartë shumë e mjeteve të ndara në këtë pozicion, në shumë 1,514,233.00€?

**znj. Ardita Rrahmani:** Ajo të cilën e kemi pa si LDK para hedhjes në votim Draft buxhetin, duke qenë së viti që po vjen, është vit elektorale, ku ju si ekzekutiv i keni orientuar projektet aty ku i keni kalkulimet, shtu këtu që asnjëri nga ne nuk jemi kundër investimeve kapitale në tërë territorin e komunës tonë. Gjatë gjithë vitit, kërkesat të cilat vijnë nga qytetarët, për me i plotësuar nevojat e tyre, të cilat ne i ngitem si LDK, nuk është ndarë kod buxhetor dhe as që janë marrë me prioritet, dhe as që janë marrë për bazë në asnjë kod buxhetor në këtë buxhet. Pjesëmarrja në debate publike ka rezultuar e njëjtë, pa bërë asnjë ndryshim nga drafti i paraqitur para debateve publike, kërkesave të cilat janë paraqitur gjatë debateve publike dhe diskutimeve, për me votuar në seancën pasuese. Buxheti është rritur fare pak, ndërkaq këtë ngritje pjesën me të madhe e marrin pagat dhe mëditjet, ndërkaq për investime kapitale mbetën pak mjete, diku 3.5 milion, të ndara në 46 kode. Nëse këto kode buxhetore i pjesëtojmë, nëse i pjesëtojmë me 5 milionëshen, i bien mesatarja 75 mijë euro për kod. 22

kode janë nën këtë shumë, ndërkaq mbetën diku 26 të tjera me shumën 80,000 euro. E dimë se thoni se ndarja nuk bëhet kështu, e po as kështu sipas prioriteteve të juaja nuk duhej të shkonte. Kaçaniku ka 32 vendbanime, iu drejtohem i juve anëtarë të KK, mos e votoni këtë buxhet. A jeni të vetëdijshëm se vetëm 8 vendbanime plus minus 1, ku me pak e ku me shumë, do të shkojnë mjetet. Kolegë anëtarë të KK, si do t'ju drejtoheni qytetarëve të komunës të cilët nuk përfitojnë asgjë nga ky buxhet nga investimet kapitale? Unë si LDK dhe ju subjektet tjera të këtij KK, pavarësisht votave, përfaqësojmë të gjitha interesat e qytetarëve të komunës së Kaçanikut. Prandaj ndarja e buxhetit është dashur të bëhet në formë proporcionale për të gjitha rajonet. Ne si LDK do të jemi kundër ndarjes se këtij buxheti.

**z. Selajdin Troni:** Desha me e falënderuar kryetarin, nënkryetarin, drejtorët për hartimin e buxhetit të vitit 2025. Ardita tha se e keni orientuar buxhetin, ku i keni më tepër votuesit. Të gjitha investimet të cilat janë bërë deri me tani dhe këto që janë propozuar në këtë draft buxhet, si në rrugë, trotuare, parqe, sheshe të qytetit, nuk janë në një fshat, por janë brenda qytetit. Ka pjesë të kanalizimeve që janë rregulluar, salla sportive, fusha sportive, ndriçimin në Kaçanik dhe gjitha fshatrat, kemi bërë mure mbrojtëse. Buxheti nuk është i ndarë në rajone, por është buxhet për tërë komunën e Kaçanikut, që kanë me gëzuar të gjithë qytetarët, edhe këta të LVV të cilët asnjëherë nuk e votuan. Buxheti është për të gjithë qytetarët, pa dallime partiake.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë fjalën votues, asnjëherë nuk e përmenda. Në anën tjetër, ju i listuat investimet të cilat janë bërë, ndërkaq unë e përmenda se investimet kapitale shkojnë në 7-8 vendbanime plus minus 1 vendbanim. Kaçaniku është vendbanim, unë nuk e përmenda se nuk po investohet në Kaçanik, po investoni në vendbanime tjera. Nëse keni qenë i vëmendshëm, po e ritheksoj edhe një herë. Unë këtu në KK, pavarësisht ku kam marrë votë, përfaqësoj interesin e të gjithë qytetarëve të komunës, qoftë në Kotlinë, Bajnicë apo nga lagja ku unë banoj Dushkajë apo nga lagja që vijë-Lagja e Re, për mua nuk ka kurrfarë dallimi. Po e ritheksoj, çdo investim që bëhet në Kaçanik, nëse edhe vetëm 2 qytetarë të kësaj komune përfitojnë, unë jam për, por për ndarjen e keni dëshmuar edhe gjatë mandatit dhe jo vetëm, por e keni të drejtën e plotë të gjykimit dhe analizimit. Tjetra është, buxheti është edhe publik, kështu që sipas neve qëndron kjo. Nëse ju keni diçka tjetër mbas kësaj, unë emrin nuk të përmenda me të dhënë të drejtën për replikë.

**z. Brahim Imishti:** Desha me pyetur Arditen nëse mundet me gjetur ndonjë fshat që nuk është investuar asnjë projekt?

**znj. Ardita Rrahmani:** Nëse keni qenë të vëmendshëm, unë në asnjë moment nuk thashë se nuk është investuar, por thashë, se nuk po flasim për një raport ku është investuar, por për një buxhet të vitit 2025, i cili buxhet përfshinë investimet në vitin 2025. E potencova se janë 8 vendbanime ku investohet plus minus një vendbanim. E kam listën këtu, mundeni me verifikuar sa investime po bëhen në investimet në iks(x) apo ipsilon (y) fshatin. Që 25 vjet jeni në qeveri, diku nuk janë bërë kalkulimet mirë, se në këtë rast Kotlina ka ngelur gati se krejt.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kur jemi të buxheti, dua të theksoj se buxheti asnjëherë nuk ndahet për lokalitete të caktuara. Buxheti ndahet me prioritete. Sot munden me qenë të përfshira në prioritete 10 vendbanime, ndërkaq në vitin tjetër fjala vjen nja 8 tjera. Buxheti çdo herë kur ndahet, ndahet sipas prioriteteve dhe është e pamundur me i mbuluar të gjitha prioritetet përnjëherë. Me një ndarje të drejtë, ekzekutivi e sjellë propozimin në KK, duke iu dhënë prioritet jo sipas kalkulimeve të komuniteteve, por sipas nevojave të qytetarëve për projektet që duhet të realizohen. Në listën prioritete, ka prioritete të mira të cilat duhet të realizohen. Të secili buxhet mundet e themi apriori, që secili mundet me pasur nga një vërejtje, por vërejtjet duhet të jenë konkrete. Fjala vjen pse po ndërtohet një rrugë në këtë lokalitet e nuk po ndërtohet në lokalitetin tjetër. Këto çështje trajtohen edhe në debate publike para qytetarëve,

para grupeve të interesit, por në tërësi nuk pajtohem me ato vendet me subjektet në opozitë ku thonë se buxheti është i keq dhe nuk e votoj, se buxhet të keq nuk ka, mundet me qenë 1-2 prioritete jo të mira, por jo të gjitha, se brenda buxhetit janë pagat dhe mëditjet, subvencionet, bursat për studentë, pagesat e transportit të nxënësve, të gjitha këto janë prioritete të mira. Për atë po themi se ndonjë projekt që mendohet se nuk është i mirë, duhet cekur konkretisht, se kjo nuk është praktikë e mirë. Kur e themi këtë e përfshijë edhe partinë time, e jo vetëm subjektin opozitë, se nuk është e mirë kjo mos me u votuar buxheti, mos me qëndruar as në mbledhje, sepse buxheti i komunës është për qytetarë. Buxheti diku me mirë, diku me pak, ka me plotësuar një nevojë të qytetarëve. Në këtë kontest, ne do të diskutojmë buxhetin, se nga shkojnë IK, ST, diskutimi duhet të jetë në këtë formë se pse kaq mjete për IK e pse kaq për ST. Asnjëherë nuk diskutohet pse kaq mjete po shkojnë për ST në këtë apo atë drejtori, e jo me u shtri diskutimi në formë politike. Më se paku diskutimi për buxhetin duhet me qenë politik. Buxheti duhet të jetë prioritet i nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Është shumë normale që kryetari e ka një program, me të cilin i ka fituar zgjedhjet dhe atij programi i kanë besuar qytetarët, dhe kryetari ka ambicie që të plotësoj apo përmbushur atë që e ka dhënë para qytetarëve. Jemi në këtu që mund të ndërhyjmë se çka nuk është në rregull, dhe ku duhet të bëhen përmirësimet, por të diskutohet buxheti në tërësi si i mirë apo i keq, për mua është absurde.

**z. Betim Shala:** Kam disa pyetje apo mendime të mia rreth ndarjes buxhetore të pozicioni i investimeve kapitale. Të rruga Runjevë-Stagovë, po e shoh se janë ndarë 30 mijë euro, meqenëse nuk di ku kanë ngelë procedurat e prokurimit për pjesën që janë ndarë sivjet. Në rast se dështon, a janë të parapara që vitin e ardhshëm me bërë ridestinim të mjeteve. Mendoj se është dashur me u ndarë me tepër mjete për këtë rrugë, e jo vetëm me u paraparë si kod buxhetor. Gjithashtu është dashur me u ndarë me tepër mjete për rrugën Bob-Doganaj, se është rrugë kyçe e Kaçanikut dhe ndikon në zhvillimin e Kaçanikut, për shkak të ardhjes se banorëve deri këtu dhe nxënësve, duhet të shtrohet asfalti i kësaj rruge. Trotuari nga Fusha e Pajtit, shuma 200 mijë euro është e vogël, marrë parasysh inflacionin, mendoj se është dashur me pak mjete me u ndarë për rrugë lokale. Projekti: Hapja e rrugës nga rruga:”Ismajl Raka”-Xhamia e Dëshmorëve, e pash si kod se janë ndarë 5 mijë euro, ndërkaq nuk po e shoh se ka mjete të ndara për shpronësimin e pronave, se aty nëse nuk hynë dikush në shpronësim me bërë ndërtim, shpronësimi duhet me u bërë me mjete të komunës.

**z. Rustem Zenuni:** Meqenëse do ishte mirë të ishte këtu edhe pjesa e opozitës, për të parë buxhetin për të diskutuar dhe vlerësuar, e kuptoj se nuk kanë çka thonë, nuk kanë mundur me kontribuar asgjë, i kanë ikur përgjegjësisë që e kanë marrë prej qytetarëve. Kam një bindje se edhe qytetarët e shohin se kanë gabuar që kanë përkrahur këta. Për mua është e rëndësishme që buxheti të cilin ia kemi vendosur bazën viteve me parë, tani në ato dimensione të cilat i kemi paraparë, një buxhet i cili nuk ka kalkulime, ka arsyetim, ka zgjidhje, një buxhet me i mirë, një problem me pak. Kjo po ndodhë në buxhetin e këtij viti. Për mua është shumë në rregull, sepse janë zgjidhur do kërkesa që kanë qenë me madhore, janë zgjidhur si prioritete. Për mua nga viti 2022 ka qenë me prioritet, Ndërtimi i rrugës, Bob-Kulla e Hasanit në Rambuje, e cila është vendosur në një seancë solemne, ka qenë prioritet me përfunduar gjatë këtij mandati. Pastaj, prioritetet që ka vazhduar e që besoj se do të vazhdojnë edhe në mandatet tjera, është: Ndërtimi i sallave sportive, për të cilat jemi shumë të kënaqur, që është investuar për përmirësimin e kushtet për nxënësit. Hap pozitiv të subvencionet dhe transferet, në DBPZHR për dallim nga viti i kaluar, 70 mijë në vitin 2024 është ngritur tani 120 mijë euro, një temë që unë e kam pasur mision në mandatin kur e kam marrë, për shkak se punoj vet në bujqësi dhe iu kam premtuar buqëve që kam me angazhuar shumë. Përtej premtimit tim, ka qenë angazhimi i ekzekutivit të komunës. Rruga “Reshat Shehu” me vjen mirë që ka hyrë në buxhet. Mesazhin duhet dërguar të qytetari, buxheti nuk është kalkulim politik, është kalkulim i zgjidhjes se problemeve dhe nevojave që na dalin për çdo ditë. Zona që përfaqësoj,

kemi pasur takim edhe me administratorin edhe me juve kryesues, trotuari nga restorant Natyra-Fusha e Pajtit, i ka ardhur fundi, një pjesë është realizuar në këtë vit, pjesa tjetër në vitin tjetër. Uroj që ky buxhet të ekzekutohet.

**z. Bahri Selimi:** Të lista e projekteve kapitale, është një ndryshim i vogël, shuma është e njëjtë, por nga rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në Kaçanik diku mbi 521,000 euro, i kemi zbritur shumën dhe e kemi ngritur shumën të 2 projekte tjera, me kërkesën e drejtorit të DUKMM, të cilat janë diskutuar me herët, por nuk ka pasur projekt. Bëhet fjalë për, Ndërtimin e mureve mbrojtëse në rrugët: "Hamzë Jashari", "Mejdi Dalloshi" dhe "Shaban dhe Isen Elezi", shuma, 50 mijë euro, dhe projekti tjetër, Zgjerimi i rrugës Gryka e Kaçanikut-Kaçanik i Vjetër, 100 mijë euro. Këto 150 mijë euro janë zbritur nga kodi, Rregullimi i rrugëve lokale. Të pyetja e Arlinda, për planifikimin e mjeteve për Mallra dhe shërbime, mallrat i kemi ngritur mbi 92 mijë euro, se po kemi problem me i mbuluar shpenzimet deri në fund të vitit, si çështja e sigurimit fizik të objekteve, se nuk po mundem me intervenuar nga programet tjera buxhetore, se jemi dëshmitar i asaj që nga muaji tetor ngritet paga minimale 350 euro, ngritja e materialit për nxehje si dru, pelet, derivatet për automjete. Krejt këto shpenzime hynë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Në vazhdim drejtori i përmendi disa nga shpenzimet që hynë në këtë program buxhetor me shumën e caktuara si në listë: Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, shpenzimet e komunikimit, si: interneti, tel. fikse, shpenzimet për shpenzime të përgjithshme, sigurimi fizik i objekteve, shpenzimet teknike dhe të anëtarësimit, mirëmbajtja e pajisjeve dhe mobileve për arsim, shëndetësi, administratë, furnizim me artikuj tjerë, furnizime shëndetësore, furnizimet e pastrimit, mirëmbajtja e rrugëve, mirëmbajtja e ndërtesave: arsimi, shëndetësi.

**znj. Arlinda Raka-Rakoci;** Kërkoj sqarim për shumën 300 mijë euro për shërbime shëndetësore

**z. Bahri Selimi:** Shërbimet shëndetësore nuk janë 300 mijë euro, furnizime mjekësore janë 50 mijë euro, ndërsa shërbime shëndetësore janë afër 15 mijë euro. Në detaje nuk i keni ju aty. Në total, mallrat dhe shërbimet në shëndetësi janë mbi 242 mijë euro. Edhe pse proklamohet në qeveri për investime nga granti specifik i shëndetësisë, shumicës së komunave iu ka zvogëluar ky grant, mbi 31 mijë euro. Në arsim proklamohet për shumë investime, kemi ngritje të grantit për 231 mijë euro, por nuk i mbulon shpenzimet, kështu jemi detyruar me ndarë mjete nga granti i përgjithshëm. Të pyetja e Ardita, ju e elaboruat se buxheti me tepër është një plan politik, buxheti sipas definicioneve me të gjëra edhe është politik, por në përgjithësi buxheti është një plan njëvjeçar. Normal, kryetarin e komunës e votojnë shumë qytetarë, për atë arsye ulet dhe e menaxhon buxhetin, por përkundër asaj, i dëgjojmë kërkesat e qytetarëve në debate publike, të cilat mbahen me rregull, se paku ato minimale që janë sipas ligjit dhe mundet çdokush me ardhur. Projektet ne nuk i kemi bash specifike për secilin projekt, nëse fjala vjen ankoheni për ndriçim publik, ke biseduar me drejtorin e drejtorisë për ndriçimin publik në lagjen e juaj. Ne i kemi do projekte me të përgjithësuara, që investohet sipas nevojave, si të ndriçimi publik, në të cilat investohet, si kanalizimi fekale e atmosferik, rrugë rurale dhe urbane, intervenojmë ku është nevoja me e theksuar. Të pyetjet tjera, të rruga Runjevë-Stagovë-Kaçanik i Vjetër, është faza e II e projektit, 80 mijë euro janë të planifikuara në vitin 2025. Të rruga Bob-Doganaj, e dimë rëndësinë e kësaj rruge, do të mundohemi me përfituar ndonjë projekt nga niveli qendror apo nga të hyrat e bartura të pashpenzuara. Të projekti i trotuarit në Fushë të Pajtit, janë 200 mijë euro të planifikuara në vitin 2025 dhe 50 mijë në vitin 2026 sipas nevojës për fazën e II. Faza I është kontraktuar sivjet, punimet janë në zhvillim e sipër.

**znj. Ardita Rrahmani:** Faleminderit për sqarime në përgjithësi. Ajo që e diskutove po besoj se ishte si shembull, jo si një kërkesë e parashtruar e imja. E kam një pyetje për kodet e reja e parapara në këtë buxhet, për të cilat në vitin 2025 nuk janë ndarë mjete, por janë ndarë për 2026 apo 2027. Pse është paraparë p.sh. si kode, ndërkaq nuk janë ndarë se paku 2 mijë euro

sikurse kodet tjera, pse ka ndodhë kjo? A ka qenë nevoja me u tërhequr edhe prej atyre kodeve, se nuk ka mjete me investuar me shumë?

**z. Bahri Selimi:** Me herët të mora si shembull Ardita, se nuk ishte puna që keni kërkuar ju ashtu. Për kodet e reja, gjasat janë me u realizuar ai projekt, dhe nuk i fusim për vlerësime në vitin 2026 apo 2027. Gjasat janë me u gjetur mjete dhe me u realizuar projektet në vitin 2025.

**znj. Ardita Rrahmani:** Drejtor, këtu ka ndodhur e kundërta, është kodi i ri, po flas për zhvillimin ekonomik, është kodi 22 për projekte zhvillimore të turizmit, kodi është i ri, por mjete për vitin 2025 nuk janë paraparë, ndërkaq në vlerësimet 2026 dhe 2027 janë paraparë mjete.

**z. Bahri Selimi:** Paska qenë e kundërta. Ajo që fola me herët qëndron, edhe pse nuk e keni bërë pyetjen me herët. Kur janë të specifikuara projektet, kur i kemi emrat dhe e dimë qëllimin e saktë, janë objektivat e qarta të drejtorisë, intensifikon projektet siç janë: Ndërtimi i shtegut të Lirisë, faza I, 5mijë euro, Ndërtimi i kioskave për biznese në Bulevard në sheshin e qytetit 25 mijë euro, Ndërtimi i ballkonit panoramik të Guri i Shpuar 50 mijë euro. Këtu i ka të qarta projektet drejtoria se ku ka me investuar, mirëpo për vitin 2026 dhe 2027 e lënë pak hapësirën për me menduar për të ardhmen dhe specifikohen me kohë projektet që investohet në turizëm.

**z. Ekrem Livoreka:** Të rruga në Kaçanik të Vjetër, çka keni paraparë aty, zgjerimin e rrugës apo edhe të trotuarit, sepse aty ka frekuentim të nxënësve, dhe ajo pjesë paraqet rrezik nga automjete që qarkullojnë në atë rrugë.

**z. Bahri Selimi:** Është kërkesë e kamotshme, se me shtimin e popullatës, me funksionalizimin e objektit për banim social, e cila pritet të bëhet sivjet, rritet frekuentimi i qytetarëve, kështu në atë pjesë ka me u bërë zgjerimi i rrugës bashkë me trotuarin. Nëse nuk arrihet përnjëherë, projekti do të realizohet në faza.

**z. Selajdin Troni:** Sa kushton projekti i rehabilitimit dhe asfaltimit të rrugës Bob-Doganaj?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 14 votë Për (12 PDK dhe 2 AAK), Kundër 4 votë- LDK, Abstenim 1- NISMA. Prezent 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027/ Lënda: 01Nr. 400/01-21277/24.**

**3.** Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e vendimit 01 nr. 60/01-38152/21 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe vendimit 01 nr. 60/01-14084/24 për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e këtij komiteti;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pas dorëheqjes se Rabije Sallahi nga pozita e anëtarit të KK, vendin e saj është Edona Luzha. Edhe në KPF do të jetë Edona Luzha. Kjo është formulë që e përcakton ligji. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me 19 votë Për. Prezent 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për ndryshim plotësimin e vendimit 01 Nr. 60/01-38152/21 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe vendimit 01 Nr. 60/01-14084/24 për ndryshim plotësimin e**

**vendimit për formimin e këtij komiteti, ashtu që në Komitetin për Politikë dhe Financa, në vend të Rabije Sallahi, caktohet Edona Luzha nga AAK-anëtar**

**Me ndryshim plotësimet që bëhen me këtë vendim, Komiteti për Politikë dhe Financa, ka këtë përbërje:**

1. <b>Kemal Murseli</b>	<b>PDK</b>	<b>Kryesues sipas funksionit</b>
2. <b>Kadri Krivenjeva</b>	<b>PDK</b>	<b>anëtar</b>
3. <b>Rrustem Zenuni</b>	<b>PDK</b>	<b>anëtar</b>
4. <b>Agim Mani</b>	<b>LVV</b>	<b>anëtar</b>
5. <b>Kadrije Lika-Troni</b>	<b>LVV</b>	<b>anëtar</b>
6. <b>Ardita Rrahmani</b>	<b>LDK</b>	<b>anëtar</b>
7. <b>Edona Luzha</b>	<b>AAK</b>	<b>anëtar/ Lënda: 01Nr. 060/01-23022/24.</b>

**4. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar 01Nr. 320/01-2238/24 të datës 10.09.2024 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet breshëri në territorin e komunës së Kaçanikut, në fshatin Duraj - Gabrricë;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për sqarime të nevojshme, drejtori është këtu. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me 18 votë Për. Prezent 18. Nuk ishte në Sallë Betim Shala. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### **VENDIM**

**Për miratimin e Raportit përfundimtar 01Nr. 320/01-2238/24 të datës 10.09.2024 të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet breshëri në territorin e komunës së Kaçanikut, në fshatin Duraj – Gabrricë/Lënda: 01Nr. 320/01-22945/24.**

**5. Plani i Veprimit në Mjedis, me veprim klimatik;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është një dokument i rëndësishëm, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** Debatin për këtë pikë e kemi shterë edhe në KPF, vetëm desha me ditur me një gabim në vlerësim që e ka bërë hartuesi, f. Kovaçec thuhet se ka mbulueshmëri nga Bifurkacioni 70%, ndërsa ka rezultuar me banorët e këtij lokaliteti që nuk janë të përfshirë, d.m.th. janë të përfshirë pjesërisht. Me intereson të di, a do të bëhet ky ndryshim në planin e veprimit të cilin do të miratojmë?

**z. Selajdin Troni:** F. Kovaçec ka mbulueshmëri me Bifurkacionin diku 30%. Gypi është pothuajse në krejt fshatin, por nuk është vënë në funksion.

**z. Rrustem Zenuni:** Jo vetëm në Kovaçec, por ka edhe vende tjera që shumë qytetarë nuk kanë dëgjuar me u kyçur në rrjetin e ujësjellësit të Bifurkacionit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë me ndryshimin e propozuar dhe i njëjta u aprovua njëzëri me 17 votë Për. Kur u votua kjo pikë, nuk ishin prezentë, Betim Shala dhe Kadri Krivenjeva. Prezent 17. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### **VENDIM**

**Për Aprovimin e Planit të Veprimit në Mjedis, me veprim klimatik/Lënda: 01Nr.060/01-22876/24.**

**5. Draft-Plani Komunal për transport lokal publik të udhëtarëve, 2024-2028;**



**Kryesuesi i Kuvendit:** Raportin e keni marrë, e kemi diskutuar edhe në KPF, është hera e parë që kemi një draft, nuk e di me herët e ka pasur, e që kërkohet të miratohet për shkak të grantit të performancës. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjta u aprovua njëzëri me 17 votë Për. Nuk ishin prezentë Betim Shala dhe Kadri Krivenjeva kur u votua kjo pikë. Prezent 17. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### **VENDIM**

**Për Arovimin e Planit Komunal për transport lokal publik të udhëtarëve, 2024-2028/Lënda: 01Nr. 104/02-22361/24.**

7. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Raportin e keni marrë, KKSB siç e dini i raporton KK më çdo 6 muaj. E hapi diskutimin:

**znj. Ardita Rrahmani:** Do të ishte mirë me bërë praktikë që kur të shqyrtohet Raporti i punës i KKSB, përveç kryetarit me qenë prezentë edhe komandanti i policisë, për arsye se e ka një rol kyç në këtë këshill, e që nuk është i vetmi anëtarë, ka edhe anëtarë të tjerë. Ajo që kisha dashur me tërhequr si vërejtje, është trajtimi i qeneve endacak, sepse sa po e shoh unë, këto mbledhje po rezultojnë vetëm me u mbledhë formalisht për me kryer një obligim ligjor, kurse marrja e hapave konkret, lënë për të dëshiruar. Lë të jetë si thirrje për hera tjera, kush e ka fatin me qenë këtu në legjislaturat tjera, e mban mend këtë, pavarësisht kush vjen, mendoj se kishte me qenë një praktikë e mirë edhe prezenca e komandantit të policisë kur shqyrtohet raporti i KKSB, që ai me elaborua me tepër raportin.

**z. Selajdin Troni:** Me intereson të di, Parku nacional a është në menaxhim të komunës.

**Kryetari i Komunës:** Parku nacional është në menaxhim të drejtorisë të parkut nacional.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës,  
**NJOFTOHET**

**Me Aktivitetin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, përmes Raportit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024/ Lënda: 01Nr. 050/01-22918/24.**

8. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2024-2025 në komunën e Kaçaniku;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Shprehi shqetësimet e mia, rënia e numrit të nxënësve në shkolla, në 180 nxënës është në nivelin fillor, që i bien për 5 klasë me pak, ndërkaq të niveli tjetër ishte me i vogël rënia e numrit të nxënësve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ky shqetësim ka qenë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa. Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës,

#### **NJOFTOHET**

**Me aktivitetin e zhvilluar të Drejtorisë së Arsimit për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2012/2024 në bazë të dhënave të prezantuara në Informatën e kësaj drejtorie/ Lënda: 01Nr. 04-610/01-22686/24.**

9. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 400/01-6738/24 të datës 29.03.2024 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të Parcelave në Zonën Kadastrale Kaçanik dhe Gajre;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozim Vendimin e keni marrë, është fjala për korrigjimin e një gabimi teknik. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj

në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me 18 votë Për. Prezent 18. Kur u votua kjo pikë, nuk ishte në sallë Kadri Krivenjeva. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### **VENDIM**

**Për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 400/01-6738/24 të datës 29.03.2024 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të Parcelave në Zonën Kadastrale Kaçanik dhe Gajre/ Lënda: 01Nr. 060/01-22999/24.**

10. Kërkesa për Dorëheqje e anëtarit të KK, Rrustem Zenuni, nga Komisioni komunal i aksionarëve NPK” stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rrustem Zenuni është emëruar anëtarë në KPF, kështu që duhet të hiqet nga komisioni. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me 19 votë Për. Prezent 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### **VENDIM**

**Për aprovimin e Kërkesës për Dorëheqje e anëtarit të KK, Rrustem Zenuni, nga Komisioni komunal i aksionarëve NPK” stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik/Lënda: 01Nr. 060/01-23149/24.**

11. Kërkesa për Dorëheqje e anëtarit të KK, Rrustem Zenuni, nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rrustem Zenuni është emëruar anëtarë në KPF, kështu që duhet të hiqet nga komisioni. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me 19 votë Për. Prezent 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### **VENDIM**

**Për aprovimin e Kërkesës për Dorëheqje e anëtarit të KK, Rrustem Zenuni, nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut/Lënda: 01Nr. 60/01-23148/24.**

12. Propozim Vendim Për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore deri në 5% sipas Buxhetit të vitit 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo pikë ka ardhur si kërkesë e drejtorit për me futur në rend pune në mbledhje të KPF. Në KK materiali iu ka ardhur me kohë. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me 19 votë Për. Prezent 19. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### **VENDIM**

**Për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore deri në 5% sipas Buxhetit të vitit 2024/Lënda: 01Nr. 400/01-24317/24.**

Pas përfundimit të pikave të rendit të punës, Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i njoftoj anëtarët e KK dhe Ekzekutivin për datën e vizitës zyrtare studimore në Turqi, 23.10.2024, nëse nuk ka ndonjë problem rreth procedurave të tenderimit, ndonjë ankese në OSHP. Ata të cilët shprehin vullnetin me ardhur në Turqi, shikoni afatin e pasaportave dhe kohën.

Në fund e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 12:45. Nga 27 anëtarë sa ishin prezentë në këtë mbledhje, deri në fund të mbledhjes qëndruan 19 anëtarë (12-PDK, 2-AAK, 4-LDK, 1- NISMA). Pas pauzës për me vazhduar me pikën dytë, nuk u kthyen: Raif Kasa dhe Naim

Beça, ndërkaq 6 anëtarët tjerë të LVV e lëshuan mbledhjen në fillim të pikës së dytë (Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Bashkim Luma, Ernesta Krasniqi, Arta Avdiu, Burim Shehu).

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit  
Kemal Murseli



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPSTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçaniku

Opština Kacanik - Municipal Kaçanik

I	Data	14.10.24	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.	01	Numri	400/03-266527
			Shtojcë	

# RAPORTI NËNTË MUJOR FINANCIAR

Per periudhën: Janar – Shtator

# 2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Për Kuvendin  
Komunal

Kryetari i komunës :

*Besim Ilazi*



Kaçanik, Tetor – 2024

## **I. Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Shtator 2024:**

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Shtator 2024 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë. Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesëve do të prezantohet për 12 (dymbëdhjetë) programet buxhetore:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata e Përgjithshme dhe Çështjet Gjinore,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxhet dhe Financa,
5. Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm,
6. Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencat,
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
8. Planifikimi Urban dhe Mjedisi,
9. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
10. Arsim,
11. Kulturë, Rini dhe Sport,
12. Zyra Lokale për Komunitete.

# RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN JANAR - SHTATOR 2024

**TABELA 1: IMPLEMENTIMI I BUXHETIT PËR PERIUdhËN JANAR - SHTATOR 2024**

TË HYRAT BUXHETORE		Buxheti i miratuar 2024	Buxheti i tanishëm 2024	Shpenzimet 30.09-2024	Shpenzimet 30.09-2023	Progresi në %	Krahasimi 2024/23 në €	Indeksi 2024/2023 (%)
		1	2	3	4	5=3/2	6=3-4	7=3/4
<b>A</b>	<b>TOTAL FINANCIMI QEVERITAR</b>	<b>11,034,783.00</b>	<b>11,034,783.00</b>	<b>7,111,060.38</b>	<b>6,854,491.51</b>	<b>64.44</b>	<b>256,568.87</b>	<b>3.74</b>
1	GRANTI I PËRGJITHSHËM	5,130,643.00	5,130,643.00	2,787,509.39	2,397,180.18	54.33	390,329.21	16.28
2	GRANTI I ARSIMIT	4,395,331.00	4,395,331.00	3,468,810.90	3,533,323.88	78.92	(64,512.98)	(1.83)
3	GRANTI I SHËNDETËSISË	1,508,809.00	1,508,809.00	854,740.09	923,987.45	56.65	(69,247.36)	(7.49)
<b>B</b>	<b>TOTAL TE HYRAT VETANAKE-PARTICIPIMET DHE DONACIONET</b>	<b>924,200.00</b>	<b>2,314,675.76</b>	<b>508,650.61</b>	<b>201,818.46</b>	<b>21.98</b>	<b>306,832.15</b>	<b>152.03</b>
4	TË HYRAT VETANAKE 2024	924,200.00	924,200.00	170,813.62	105,421.47	18.48	65,392.15	62.03
5	TË HYRAT E BARTURA NGA VITI PARAPRAK	-	1,098,068.10	238,763.06	96,396.99	21.74	142,366.07	-
6	BARTJET E FONDEVE TË VITITER PARAPRAKE: DONATORËT, PARTICIPIMET	-	292,407.66	99,073.93	-	33.88		
<b>TOTALI (A+B)</b>		<b>11,958,983.00</b>	<b>13,349,458.76</b>	<b>7,619,710.99</b>	<b>7,056,309.97</b>	<b>57.08</b>	<b>563,401.02</b>	<b>7.98</b>

Te hyrat e bartura nga viti 2023 ne vitin 2024 deri ne qershorë 2024 867,857.42  
 Te hyrat e bartura pas datës 30 qershorë 2024 230,210.68  
 Totali i HVK të bartura nga viti 2023 ne vitin 2024 1,098,068.10

Bartjet e fondeve nga donatorët nga viti kaluar ne vitin aktual 5,678.30  
 Donacionet e pranuarë ne 2024-Granti i Performancës 286,729.36  
 Total pranimet nga donacionet e jashtme 292,407.66

-Buxheti i miratuar i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2024, është caktuar sipas Qarkores Buxhetore nr.2024/01 me kufijtë buxhetor fillestar në shumë prej: **11,958,983.00€**.

-Mjetet e bartura nga vitet paraprake te cilat i janë shtuar buxhetit aktual janë ne shumë totale prej **1,098,068.10** euro. Kështu shuma e buxhetit të tanishëm ka arritur në **13,349,458.76** euro.

- Burimet e rregullta të financimit të Buxhetit Komunal vijnë nga:

1. Granti i përgjithshëm ..... 5,130,643.00 €
2. Granti specifik i arsimit: ..... 4,395,331.00 €
3. Granti specifik për shëndetësi: ..... 1,508,809.00 € dhe
4. Të hyrat vetanake: ..... 924,200.00 €

## Struktura e përbërjes së buxhetit të miratuar sipas burimeve të financimit duket kështu:

Grantet Qeveritare: ..... 11,034,783.00 € apo 92.27 % e buxhetit total,

HVK – Projeksionet : ..... 924,200.00 € apo 7.73 % e buxhetit total.

-Shpenzimi total per periudhen Janar – Shtator 2024 është në shumë prej 7,619,710.99€ apo 57.08% e planifikimit vjetorë 2024.

## II. Raporti i inkasimit të të hyrave vetanake:

Të hyrat vetanake direkte të grumbulluara gjatë periudhës raportuese kanë arritur lartësinë e realizimit prej **569,674.48€** që përbëjnë **61.64%** të planifikimit të gjithëmbarshtëm vjetorë në shumë prej **924,200.00€**. Këto të hyra për periudhën Janar-Shtator 2024 janë krijuar sipas burimeve të identifikuara nga të gjitha Drejtoritë bazuar në planifikimet vjetore.

- Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave janë grumbulluar gjithsej: **313,283.85€** apo **55%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit janë grumbulluar gjithsej mjete në shumë prej: **125,130.43€** apo **22%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Shuma tjetër e grumbullimit të mjeteve , është realizuar nga këto pesë (6) programe apo drejtori: Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shuma prej: **24,329.12€**, Administratës së Përgjithshme, shuma prej: **16,763.00€**, Arsimit **28,836.00€**, Drejtoria e Bujqësisë, Plltarisë dhe Zhvillimit Rural, shuma prej: **42,725.13€**, Drejtoria e Shërbimeve Publike, shuma prej: **16,936.95€** dhe Zyra e Inspektoriatit shuma prej **1,670.00€** që së bashku përbëjnë **23%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Krahasuar me inkasimin e realizuar të vitit 2023 të së njejtës periudhë, nga raporti i realizimit të HVK-së të vitit 2024 del se janë inkasuar mjete prej: **164,225.26 €** më pak se në vitin 2023 nga të hyrat direkte.

- Rënia në grumbullimin e të hyrave vetanake të Tatimit në Pronë, fillimisht ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në Ligjin e Tatimit në pronë, ku sipas ligjit të ri është rritur vlera e zbritjes për secilin tatimpagues për pronën e cilësuar për **banim primarë** nga **15,000.00€** në **30,000.00€**, ndryshimet tjera sipas UA nga Qeveria siq është heqja e kushtëzimeve administrative me rastin e regjistrimit të veturave, ndryshimeve tjera kadastrale si psh.shitë-blerja e pronave private nga tatimpaguesve borgjlinjë në tatim prone, poashtu edhe rënia nga taksat për leje ndërtimore të Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinorë dhe Mjedisit.

Të hyrat indirekte të cilat realizohen nga Gjykatat, Policia dhe Agjensioni Pyjor i Kosovës nuk na janë dërguar ende. Keto të hyra meqë realizohen nga keto institucione tjera, nuk përfshihen në planifikim por vetëm si realizim sepse edhe shpenzimi i tyre i takon komunave.

- Ndërsa tabela në vijim paraqet në mënyrë të përgjithshme realizimin e hvk-së për periudhën raportuese, krahasimin e realizimit mes drejtorive dhe viteve:

Emertimi i të hyrave vetanake	Planifikimi Janar-Dhjetor 2024	Realizimi: Janar Shtator 2024	Plani/Realizimi vjetorë (në %)	Realizimi: Janar-Shtator 2023	Krahasimi 2024/2023
Tatimi në pronë	391,545.00	150,884.91	38.54	300,507.98	(149,623.07)
Tatimi në tokë	80,543.00	101,377.44	125.87	85,399.93	15,977.51
Taksa nga regjistrimi i automjeteve	70,000.00	59,075.00	84.39	53,120.00	5,955.00
Taksa nga ushtrimi i veprimtarisë	3,000.00	360.00	12.00	2,530.00	(2,170.00)
Taksa tjera	1,000.00	1,586.50	158.65	290.10	1,296.40
<b>Total: Buxhet dhe Financa</b>	<b>546,088.00</b>	<b>313,283.85</b>	<b>57.37</b>	<b>441,848.01</b>	<b>(128,564.16)</b>
Taksa komunale për leje ndërtimi	190,000.00	26,394.56	13.89	110,955.36	(84,560.80)
Taksa për regjistrimin e trashigimisë	2,000.00	-	-	1,478.92	(1,478.92)
Taksa tjera Administrative	1,000.00	65,686.61	6,568.66	41,035.50	24,651.11
Taksa për çerifikata të pronësisë dhe kopje plan	15,000.00	6,761.00	45.07	9,759.00	
Taksa për leje mjedisore	12,000.00	2,141.67	17.85	11,485.92	
Taksa për legalizimin e objekteve	10,000.00	11,417.59	-	7,696.92	
Shfrytëzimi i pronës publike	16,812.00	80.00	0.48	4,720.26	(4,640.26)
Taksa për matjen e tokës në teren	7,000.00	12,649.00	180.70	10,049.00	2,600.00
<b>Total: Urbanizmi &amp; Kadastr</b>	<b>253,812.00</b>	<b>125,130.43</b>	<b>49.30</b>	<b>197,180.88</b>	<b>(63,428.87)</b>
Shfrytëzimi publik për tregti të hapur (reklamat)	1,600.00	2,035.20	127.20	2,633.10	(597.90)
Taksa për parking publik	10,000.00	14,901.75	149.02	5,958.50	
Taksa tjera Administrative	100.00	-	-	143.00	(143.00)
<b>Total: Shërbimet Publike dhe Emergjencia</b>	<b>11,700.00</b>	<b>16,936.95</b>	<b>144.76</b>	<b>8,734.60</b>	<b>(740.90)</b>
Taksa e Ndërrimit Destinimit të Tokës	20,000.00	39,567.40	197.84	24,890.77	14,676.63
Taksa për Shfrytëz. e Resurseve nat.	2,000.00	-	-	5,599.98	(5,599.98)
Taksa tjera	2,000.00	3,157.73	157.89	630.00	2,527.73
<b>Total: Bujqësia dhe Pylltaria</b>	<b>24,000.00</b>	<b>42,725.13</b>	<b>178.02</b>	<b>31,120.75</b>	<b>11,604.38</b>
Taksa e çertifikatave të lindjes	15,000.00	13,614.00	90.76	7,233.00	6,381.00
Taksa e çertifikatave të kurorëzimit	5,000.00	1,750.00	35.00	1,666.00	84.00
Taksa e çertifikatave të vdekjes	1,000.00	418.00	41.80	494.00	(76.00)
Taksa e çertifikatave tjera ofiçare	5,000.00	811.00	16.22	9,456.00	(8,645.00)
Taksa tjera Administrative	1,000.00	170.00	17.00	98.00	72.00
<b>Total: Administrata e Përgjithëshme</b>	<b>27,000.00</b>	<b>16,763.00</b>	<b>62.09</b>	<b>18,947.00</b>	<b>(2,184.00)</b>
Gjobat nga Inspektorati	5,000.00	1,670.00	33.40	6,170.00	(4,500.00)
Inspektimi higjieniko-sanitarë	200.00	-	-		-
Inspektimi i respektimit të planit Urb.	200.00	-	-		-
Licencat pranimit tekn. lokalit	200.00	-	-		-
<b>Total: Të hyrat nga Inspektoriati</b>	<b>5,600.00</b>	<b>1,670.00</b>		<b>6,170.00</b>	<b>(4,500.00)</b>
Taksa për çertifikata mjekësore	10,000.00	7,125.00	71.25	6,304.00	821.00
Participimet në shëndetësi	10,000.00	17,204.12	172.04	10.00	17,194.12
<b>Total: Shëndetësia dhe M.S.</b>	<b>20,000.00</b>	<b>24,329.12</b>	<b>121.65</b>	<b>6,314.00</b>	<b>18,015.12</b>
Participimet	36,000.00	28,836.00	80.10	23,584.50	5,251.50
<b>Total: Arsimit dhe Kultura</b>	<b>36,000.00</b>	<b>28,836.00</b>	<b>80.10</b>	<b>23,584.50</b>	<b>5,251.50</b>
<b>GJITHSEJ TË HYRAT DIREKTE</b>	<b>924,200.00</b>	<b>569,674.48</b>	<b>61.64</b>	<b>733,899.74</b>	<b>(164,225.26)</b>



### III . Shpenzimet e realizuara për periudhën Janar – Shtator 2024:

Dinamika e shpenzimeve për këtë periudhë është realizuar me **57.08 %** në raport me Buxhetin aktual apo shuma prej **7,619,710.99€** ndërsa krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shkallën e shpenzimit prej **7.98%** më shumë apo shumën prej: **563,401.02€**.

KATEGORITE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE (KESH)		Buxheti aktual 2024	Shpenzimet e realizuara 30.09-2024	Shpenzimet e realizuara 30.09-2023	Progresi përball plan. buxhetor	Krahasimi: Buxheti - Shpenzimet	Krahasimi 2024 / 2023 në €	Krahasimi 2024/2023 në %
		1	2	3	4=2/1	5=1-2	6=2-3	7=2/3
1	Pagat dhe medijtjet	6,759,178.84	4,934,003.67	4,583,219.08	73.00	1,825,175.17	350,784.59	7.65
2	Mallrat dhe shërbimet	1,458,206.02	822,284.91	761,615.98	56.39	635,921.11	60,668.93	7.97
3	Shpenzimet komunale	252,245.64	128,103.73	79,249.89	50.79	124,141.91	48,853.84	61.65
4	Subvencionet dhe transferet	558,464.16	247,427.84	188,186.75	44.31	311,036.32	59,241.09	31.48
5	Shpenzimet kapitale	4,296,364.10	1,487,890.84	1,444,038.27	34.63	2,808,473.26	43,852.57	3.04
6	Rezerva komunale	25,000.00	-	-	-	25,000.00	-	-
<b>TOTALI (1 deri 6)</b>		<b>13,349,458.76</b>	<b>7,619,710.99</b>	<b>7,056,309.97</b>	<b>57.08</b>	<b>5,729,747.77</b>	<b>563,401.02</b>	<b>7.98</b>

**Tabela e planifikimit të ndarjeve buxhetore sipas Drejtorive apo Programeve Buxhetore për vitin 2024:**

SEKTORI - DREJTORIA:	PAGA DHE MEDITJE	MALLRA DHE SHERBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	INVESTIME KAPITALE	TOTALI
ZYRA E KRYETARIT	247,733.53	20,000.00	-	60,000.00	-	327,733.53
ADMINISTRATA E PERGJITHSHME & Q.Gjinore	154,956.21	85,000.00	15,000.00	-	412,000.00	666,956.21
KUVENDI KOMUNAL	221,755.26	5,000.00	-	-	-	226,755.26
ZHVILLIMI EKONOMIK	23,954.42	5,000.00	-	40,000.00	335,000.00	403,954.42
BUXHETIMI - FINANCAT	80,601.27	10,000.00	-	-	250,000.00	340,601.27
SH.PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMERGJENCA	245,600.91	310,000.00	80,000.00	60,000.00	496,313.00	1,191,913.91
ZYRA E KOMUNITETEVE	10,439.86	1,000.00	-	-	-	11,439.86
BUJQESIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL	104,111.60	10,000.00	-	100,000.00	50,000.00	264,111.60
URBANIZMI - PLANIFIKIMI URBAN	116,206.76	65,000.00	-	-	1,012,279.00	1,193,485.76
AD.SHËND. DHE SHERBIMET SOCIALE	88,225.95	5,000.00	5,000.00	10,000.00	5,000.00	113,225.95
SHERBIMET SHENDETESORE PRIMARE	1,138,296.07	290,513.00	50,000.00	-	50,000.00	1,528,809.07
KULTURA, RINIA, SPORTET	131,628.93	130,000.00	15,000.00	70,000.00	135,000.00	481,628.93
ARSIMI DHE SHKENCA	4,208,367.24	385,000.00	50,000.00	50,000.00	515,000.00	5,208,367.24
<b>TOTAL BUXHETI:</b>	<b>6,771,878.00</b>	<b>1,321,513.00</b>	<b>215,000.00</b>	<b>390,000.00</b>	<b>3,260,592.00</b>	<b>11,958,983.00</b>

**Tabela në vijim paraqet shpenzimin sipas Programeve Buxhetore dhe atë sipas K.Ekonomike Janar-Qershor 2024:**

NR	PROGRAMET BUXHETORE (11)	Stafi i lejuar	Pagat dhe mëditje	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Totali	Struktura në % sipas (PB)
1	Zyra e kryetarit	27	122,729.82	22,504.41	-	25,700.00		170,934.23	3.79
2	Administrata e pergjithshme	25	79,558.72	40,917.44	10,106.08			130,582.24	2.89
3	Zyra e kuvendit komunal	23	111,858.48	550.80				112,409.28	2.49
4	Financat, Buxheti	11	33,149.47	-				33,149.47	0.73
5	Zhvillimi Ekonomik, Turizmi	3	10,858.74	456.90			91,634.25	102,949.89	
6	Shërbimet publike dhe emergjenca	28	149,889.88	221,732.42	38,380.16	14,175.00	197,713.87	621,891.33	13.78
7	ZLK	1	5,445.39	-				5,445.39	-
8	Bujqësia, Pylltaria dhe ZHR	15	22,065.55	1,539.91				23,605.46	0.52
9	Kultura, Rinia dhe Sportet	18	56,230.54	27,683.29	9,283.21	58,450.00	33,524.12	185,171.16	
10	Planifikim urban dhe mjedisi	13	50,599.41	10,688.36			114,437.84	175,725.61	3.89
	<b>ADMINISTRATA KOMUNALE</b>	<b>164</b>	<b>642,386.00</b>	<b>326,074</b>	<b>57,769</b>	<b>98,325</b>	<b>437,310</b>	<b>1,273,743.01</b>	<b>28.21</b>
11	Shëndetësia dhe mireqenia soc.	130	542,963.86	67,299.01	10,195.11	1,500.00	4,313.64	626,271.62	13.87
12	Arsimi	535	2,142,595.51	68,485.81	16,312.56	34,123.00	64,848.20	2,326,365.08	51.53
	<b>TOTALI (1 deri 11)</b>	<b>829</b>	<b>3,327,945.37</b>	<b>461,858.35</b>	<b>84,277.12</b>	<b>133,948.00</b>	<b>506,471.92</b>	<b>4,514,500.76</b>	<b>100.00</b>
	<b>Struktura ne % sipas (KESH)</b>		<b>73.72</b>	<b>10.23</b>	<b>1.87</b>	<b>2.97</b>	<b>11.22</b>	<b>100.00</b>	

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE NË MALLËRA DHE SHËRBIME											Sipas gjendjes më 30.09.2024				
KESH	MALLËRAT DHE SHËRBIMET	Zyra e Kryetarit	Zyra e Kuvendit	Administrata e Përgjithshme	Financat & Zhvillimi Ekonomik	Sherbimet Publike	Bujqësia, Pyltaria e ZHR	Urbanizimi dhe Kadastrë	Kultura-Rritja-Sportet	Arsimi-Shkenca	Shëndetësia dhe MS	Totali TMS/2024	Struktura - në %	TM3 2023	Dallimi ne EURO
13130	UDHËTIMET ZYRTARE BRENDA VENDIT	7,350										7,350	1	4,095	(4,095)
13140	UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT											69	1	403	6,947
13143	SHPENZIMET E TJERA PËR UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT				69							91	0	481	(390)
13310	SHPENZIMET E INTERNETIT			3,561				91				3,561		4,184	-
13320	TELEFONIA MOBILE											5,046	1	9,775	(4,729)
13360	SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE			121	4,926									531	-
13330	SHERBIMET POSTARE													2,417	-
13410	SHPENZIMET E ARSIMIT E TRAJNIMIT													2,470	14,192
13420	SH E PËRFAQËSIMIT DHE AVOKATURËS										3,852	3,852	0	-	-
13430	SHERBIMET E NDËRSHMË SHËNDETËSORE									100		16,662	2	2,470	14,192
13440	SHERBIMET KESHILLDHËNËSE DHE PROFESIONALE	1,383		11,724	955				2,500		12,250	12,250		-	-
13445	SHERBIMET E VECANTA-KONSULENTE DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL													-	-
13450	SHPENZIMET e shpËrjes-jomarketing													-	-
13470	SHERBIMET TEKNIKE	3,900			70	100			2,315	1,350	7,735	7,735	1	7,151	584
13475	SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE PUBLIKE			12,273					28,052	3,507	17,533	61,365	5	126,954	(62,678)
13480	SHERBIMET KONTRAKTUESË TJERA							21,117				44,277	1	5,511	490
13480	SHPENZIMET E ANETARËSIMIT	5,011			990							6,001	1	-	-
13490	SHPENZIMET E VARRIMIT													-	-
13501	MOBIJET (më pak se 1000 euro)										3,460	3,460	0	14,727	(11,267)
13502	TELEFONA (Më pak se 1,000 euro)													-	-
13503	KOMPUTERËT													-	-
13504	HUARDER PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE													-	-
13505	MAKINA FOTOKOPJESË-MULTI FUNKSIONALE				700									-	-
13560	SHPENZIMET E PAISJES SPECIALE MJEKËSORE													-	-
13508	SHPENZIMET E PAISJEVE TJERA <1000			708							3,120	3,828	0	3,776	(3,776)
13559	PAISJA TJERA													-	-
13610	FURNIZIMET PËR ZYRË	2,215	43	2,193	401	285		1,316	2,110	8,879	584	18,025	2	15,072	2,953
13620	SHPENZIMET E FURNIZIMIT ME USHQM E PIJE (JO DREKA ZYRTARE)		90	1,164					176	9,745	635	11,811	1	13,581	(1,770)
13630	FURNIZIMET MJEKËSORE													15,908	5,667
13640	FURNIZIMET E PASTRIMIT			1,390		102			2,610	9,164	1,392	14,658	2	11,830	2,827
13650	SHPENZ E FURNIZIMEVE ME VESHMBATHJE													-	-
13710	SHPENZIMET E VAJIT								6,561			6,561	1	743	5,818
13720	NAFTA PËR NGROHJE QENDRORE													-	-
13730	VAJ PËR NGROHJE													-	-
13750	SHPENZIMET E QYMYRIT													-	-
13760	DRUTE DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE			10,301			4,152			157,097		171,550	21	129,261	42,289
13780	DERIVATET PËR AUTOMJETE,GJENERATORE DHE MAKINERI			7,201		3,198	1,080		664	600	11,067	23,809	3	30,582	(6,773)
13810	AVANCE (PARADHËNIA) PËR PARA TË IMËTA													500	(500)
13770	SHPENZ E DERIVATEVE PËR GJENERATOR													3,111	(3,111)
13911	PROVIZIONI I AQBK													-	-
13950	REGJISTRIMI & SIGURIMI I AUTOMJETEVE	449		560		879		487	940	303	1,014	4,633	1	4,070	563
13953	SIGURIMI I NDËRTHESAVE DHE DHE TJERA													-	-
14010	MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE	105		2,858		834	419	325	254		3,256	8,051	1	14,225	(6,174)
14020	MIRËMBAJTJA E RIPARIMI I NDËRTHESAVE			16,702		157		380	2,111			19,350	1	75,699	(75,699)
14023	MIRËMBAJTJA E NDËRTHESAVE ADMINISTRATIVE DHE AFARISTE													-	-
14024	MIRËMBAJTJA E NDËRTHESAVE SHËNDETËSORE										2,288	6,913	1	-	6,913
14032	MIRËMB E RRUGEVE LOKALE													-	-
14060	MIRËMBAJTJA RUTINORE							22,156				230,563	28	236,921	(6,358)
14040	MIRËMB E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE													-	-
14050	MIRËMBAJTJA E MOBIJEVE DHE PAISJESJEVE			238										-	-
14130	QERAJA PËR PAISJE													-	-
14210	REKLAMAT DHE KONKURSET													-	-
14230	SHPENZIMET PËR INFORMIM PUBLIK													-	-
14220	BOTIMET E PUBLIKIMEVE													-	-
14310	KOMPENZIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT	2,157	609	4,429	513	95	41	680		339		8,863	1	1,546	7,317
14410	VENDIMET GJYEQËSORE	1,139		7,390		15,994						2,787	3	9,509	17,801
14415	PAGESAT PËR TARIFA-VENDIMET GJYEQËSORE/PËRMBARIMORE											2,700		-	-
	TOTALI I SHPENZIMEVE :	23,710	742	82,812	6,623	288,253	5,692	46,552	48,388	221,246	96,267	822,285	100	761,616	60,669
	Struktura e plesëmarrjes	2.88	0.99	10.07	1.05	35.06	0.69	5.66	5.88	26.91	11.71	100			

## **SHPALOSJA E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE:**

**KODI 13440 - SHERBIMET KESHILLDHENESE DHE PROFESIONALE:** Këtu bëjnë pjese pagesat ndaj Administratoreve të fshatrave në shume prej 11,724.00 euro të kompensuara nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, shuma prej 1,383.00 euro nga Zyra e Kryetarit për kompensimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit, anëtarëve të KKS-së shuma prej 2,500.00 euro nga Drejtoria e Kultures, Rinisë dhe Sporteve për kompensimin e anëtarëve të komisioneve të themeluara për vlerësim të aplikacioneve për financim të OJQ-ve të ndryshme dhe nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave shuma prej 955.00 euro për kompensimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit.

**KODI 13475 - SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE:** Deri në vitin 2023 shpenzimet për sigurimin fizik të objekteve kanë qenë të përfshira në kodin 13460 të shërbimeve kontraktuese tjera. Ndërsa nga viti 2024 Thesari-MFPT ka specifikuar në planin e ri kontabël kodin e veçantë për sigurimin fizik të objekteve, për këtë arsye në kodin 13460 të shërbimeve kontraktuese tjera figurojnë më pak shpenzime krahasuar me periudhën e njëjtit të vitit të kaluar.

**KODI 13760 - DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE:** Në planin e ri kontabël të hartuar nga Thesari-MFPT, këtu përfshihen: drutë, peleti, etj furnizime nga druri për nxemje.

**KODI 14410 - SHPENZIMET E VENDIMEVE TË GJYKATAVE:** Për Sulahe Luzha-lende përbarimore shuma 7,390.02 euro kompensim për parcela - Administrata e Përgjithshme. Për Qefsere Koraqi-lende përbarimore-padi për shpronësim prona me rastin e ndërtimit të trotuarit përgjatë rrugës Bob-Doganaj, shuma prej 3,672.34 euro dhe për Grand Construction Shpk-ZP Shala Shpk-lende përbarimore-padi për kompensim të situacionit përfundimtar të pagesës të kontratës vjetore për mirëmbajtje të rrugëve të vitit 2020, shuma prej 12,321.57 euro - Shërbimet Publike. Aliu Law Shpk – lende përbarimore të Shëndetësisë shuma prej 2,699.62 euro.

**KODI 14032 - MIRËMBAJTJA E RRUGËVE LOKALE:** Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve lokale për kontratën e vitit 2024 në shumë prej 140,692.16 euro, shuma prej 38,161.04 euro pagesat e obligimeve të kontratës së vitit 2023 si, shuma prej 25,039.82 euro kompensimi i inflacionit ndaj operatoreve ekonomik konform Ligjit për Punët Publike, mirëmbajtja e ndriqimit publik në shumë prej 16,799.50 euro, rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët lokale të komunës shuma prej 9,870.50 euro.

**KODI 14060 - MIREMBAJTJA RUTINORE:** Te Drejtoria e Shërbimeve Publike janë kryer pagesat për obligimet e vitit të kaluar në shumë prej 2,389.60 euro për mirëmbajtjen e hapsirave publike të xhelbruara sipas marrëveshjes me KRM Pastertia dhe për pagesën e obligimeve të vitit të kaluar për kontratën dekorimi i qytetit për festat e fundit, ndërsa shuma prej 31,971.35 euro janë pagesa e situacioneve për mirëmbajtjen e hapsirave xhelbruese për periudhën janar-qershor 2024 sipas marrëveshjes me KRM Pastertia për vitin 2024 dhe shuma prej 22,156.00 euro në Drejtorinë e Urbanizmit për kontratën e deponimeve ilegale.

1. Elektroteknikë me profilet: Teknik i Informatikës, Instalues Elektrikë dhe Elektronikë industriale me nga 1 paralele,
2. Ekonomi me profilet: Kontabilitet dhe Tatime dhe Tregti me shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele dhe
3. Makineri me profilet: Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit me 2 paralele, Automekanik dhe Metalpunues me nga 1 paralele dhe
4. **Juridik me profilin:** Nëpunës i administratës dhe shërbimeve të zyrës me një paralele

## 2. Qëllimi

Informata ka për qëllim që institucionet komunale dhe publiku i gjërë të njoftohen dhe informohen mbi gjendjen e përgjithshme në fushën edukative-arsimore në nivelet shkollore 0,1,2 dhe 3 (Parafillor, Arsimin Fillor, Arsimin e Mesëm të Ulët dhe Arsimin e Mesëm të Lartë) të komunës sonë për vitin shkollor 2023/2024.

DA, duke vepruar me kompetencë e përgjegjësi dhe në përputhje me Udhëzimet e MASHIT-it për DA-të, Ligjin Nr.04/ L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, fuqimisht mbështet ngritjen e cilësisë në procesin mësimor, përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies e të nxënësve të bazuar në rezultate dhe në zhvillimin e kompetencave duke implementuar Kurrikulën e re të Kosovës, me pjesëmarrje aktive të mësimitdhënësve.

Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të mësimitdhënësve, gjatë muajve qershor – korrik 2024, 61 mësimitdhënës të nivelit 6-9 (mesëm të Ulët) e kanë vijuar trajnimin me temë: “Zhvillimi i të menduarit kritik dhe kreativ tek nxënësit” dhe 31 mësimitdhënës të nivelit 1 - 5 (fillor) e kanë vijuar trajnimin me temë: “Plani individual i Arsimit - Planifikimi sipas nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta, hartimi i

planit individual arsimor për nxënësi me aftësi të kufizuara”. Trainimi është organizuar nga Drejtoria e Arsimit, ndërkëq është mbështetur me 3,320 (tremijë e treqind e njëzet) euro, nga buxheti i Komunës.

### **3. Objektivat**

- Edukimi në fëmijëri të hershme, respektivisht rritja e përfshirjes dhe qasja e barabartë në edukimin në fëmijëri të hershme
- Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor; respektivisht gjithëpërfshirja që mundëson mbështetje për të gjithë nxënësit pavarësisht gjendjen e tyre fizike, intelektuale, sociale etj.
- Ngritja e cilësisë së arsimit përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësor
- Digitalizimi i arsimit, përdorimi i teknologjisë digjitale me qëllim të rritjes së përdorimit të teknologjisë digjitale dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim
- Rritja e performancës së shkollës përmes menaxhimit profesional e të përgjegjshëm të sistemit arsimor i bazuar në transparencë e llogaridhënie
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve për metodologjinë e mësimdhënjes dhe zbatimin e Kurrikulës së re të Kosovës si proces për zhvillimin dhe ngritjen profesionale
- Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, vlerësim i bazuar në rezultatet e të nxënët dhe reflektimi i performancës së nxënësit
- Sigurimi i mjedisit të sigurtë/qetë, të pastër e të favorshëm në shkollë e po ashtu mbrojtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve

### **4. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimit parafillor dhe fillor (0 dhe I)**

Duke u bazuar në plan – programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit edukativ-arsimor dhe me qëllim të përmirësimit të sistemit arsimor, janë bërë të gjitha përpjekjet për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor por dhe eliminimin e dobësiave dhe menaxhimin më cilësor të këtyre niveleve duke siguruar një sistem të plotë dhe efikas. Zhvillimi dhe edukimi i hershëm i fëmijëve ndikon në krijimin e personalitetit , krijimin e

identitetit personal të fëmijut, ngritjen e vetëbesimit, fillimin e zhvillimit të njohurive e shkaktësive në mënyrë që të vazhdojnë shkollimin – nivelin e mesëm të ulët e më tej.

#### **4.1 Rrjeti shkollor**

Gjatë viti shkollor 2023/2024 kanë funksionuar 11 shkolla amë fillore dhe të mesme të ulëta dhe 10 paralele të ndara fizike:

1. SHFMU “Emin Duraku” në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë dhe Runjevë
2. SHFMU “Idriz Seferi” në Bob me paralelet e ndara në Kovaçec e Gajre
3. SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec me paralelen e ndarë në Nikaj
4. SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli
5. SHFMU “Ali Asllani” në Doganaj
6. SHFMU “Nazmi Osmani” në Elezaj me paralelen e ndarë në Bajnicë
7. SHFMU “Qamil Ilazi” me paralelen e ndarë në Fushë të Pajtitit
8. SHFMU “7 Shtatori” në Begracë
9. SHFMU “Agim Bajrami në Stagovë
10. SHFMU “ Garurr Luma” në Gillobogicë dhe
11. SHFMU “Dituria” në Ivajë me paralelen e ndarë në Strazhë

DA, përveç tjerash edhe gjatë këtij viti shkollor synim kryesor kishte përmirësimin e kushteve elementare dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore me qëllim të ngritjes dhe avansimit të cilësisë dhe sigurimin e ambientit të shëndetshëm për zhvillimin e procesit mësimor.

Bazuar në kushtet ekzistuese, gjendjen e objekteve shkollore, inventarit shkollor, furnizimin e shkollave me kabine, tabela digitale (tabela të menqura) e mjete e pajisjeve tjera dhe ndërtimi i palestrave sportive në disa shkolla, kanë krijuar kushte solide infrastrukturore dhe mundësi për avansimin dhe ngritjen e cilësisë në mësim, ndërkaq objekti ish-kollës fillore (të vjetër) në qytetin e Kaçanikut vazhdon të mbetet në gjendja tejet të rëndë pasi objekti shkollor nuk plotëon kushtet minimale për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Në Komunën e Kaçanikut gjatë këtij viti shkollor kanë funksionuar gjithsej 21 shkolla të nivelit fillor e të mesme të ulëta, prej tyre 15 shkolla nëntëvjeçare (1-9), 4 shkolla fillore 1-5; (ShF “Emin Duraku” në Kaçanik, ShF “Emin Duraku” - paralelja në Runjevë, ShF “Kadri Zeka” - paralelja në Vataj dhe ShF “Qamil Ilazi” - paralelja në Fushë të Pajtimit ) dhe një shkollë jo e plotë fillore (1-4 , në Provoli, paralele e ndarë fizike e ShFMU “Kadri Zeka)).

#### **4.2 Nxënësit e nivelit 0 dhe 1 (Parafilior dhe Fillor) dhe suksesi**

Numri i fëmijve parashkollor në këtë vit shkollor ishte 378, prej tyre 351 në shkollat fillore e të mesme të ulëta e 27 fëmijë të tjerë të sistemuar në QEAP “Agimi”, ndërkaq numri i nxënësve filloristë ka regjistruar në fillim të vitit ka qenë gjithsej 2209, ndërsa prej tyre kanë vijuar gjithsej 2165.

Në nivelin fillor nga gjithsej 2209 nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor, kanë vijuar 2165, ndërsa sukses pozitiv kanë treguar 2165, aq sa edhe kanë vijuar apo shprehur në përqindje 100 % . Të pa notuar, apo nxënës që nuk kanë vijuar kanë mbetur 44 nxënës. Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të këtij niveli më atë të vitit të kaluar (2276 nxënës), atëherë del se në këtë vit shkollor 2023/2024 kanë qenë të regjistruar 67 nxënës më pak, ndërkaq nota mesatare e këtij niveli arsimor është 4.10.

Tabela Nr.1

Suksesi i nxënësve në Arsimin Fillor (I – V) në fund të vitin shkollor 2023-2024

Lloji i klasës	SUKSESI POZITIV												SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR		Nota mesatare						
	Gj. nxenes		Vlojnë		Shkelq.		Sh. mire		Mire		Matf.		Gj. pozitiv		%		Me 1x1	Me 2x1	Me 3x1	Gj. negativ		Nuk vijon	Te greqjis				
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F			
I	452	226	440	220	283	146	82	28	55	38	20	8	440	220	100	0	0	0	0	0	0	0	4	2	8	4	4.2
II	453	221	450	219	271	144	99	43	57	23	23	9	450	219	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2	4.13
III	428	189	417	188	229	119	83	31	83	31	22	7	417	188	100	0	0	0	0	0	0	4	0	7	1	4.09	
IV	436	216	425	214	207	127	98	44	79	27	41	16	425	214	100	0	0	0	0	0	0	1	0	10	2	4.02	
V	440	204	433	200	217	125	104	43	76	26	36	6	433	200	100	0	0	0	0	0	0	2	2	5	2	4.1	
I-V	2209	1056	2165	1041	1207	661	466	189	350	145	142	46	2165	1041	100	0	0	0	0	0	0	11	4	33	11	4.1	

### 5. Nxënësit e niveleit 2 (VI – IX) dhe sukseesi

Numri i nxënësve në nivelin e AMU gjatë viti shkollor 2023/2024 ishte 1788, prej tyre 854 femra, ndërsa rezultat pozitiv kanë arritur gjithsej 1734 ose 96,97 %, ndërkaj me nota të pamjaftueshme kanë mbetur 7 nxënës apo 0.39 dhe të pa notuar apo që nuk kanë vijuar janë 47 të tjerë ose 2.63 %. Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të këtij niveli me atë të një viti më parë (1843 nxënës), atëherë del se në këtë vit shkollor janë 55 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare del të jetë 3.62.

Tabela 2.

Sukseesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI – IX) në fund të vitit shkollor 2023-2024

Klasa	SUKSESI POZITIV														SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR		Nota mesatare								
	Gj. nxenes		Vijojné		Shkelq.		Sh. mire		Mire		Matf.		Gj. pozitiv		%		Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1			Gj. negativ		Nuk vijoi Te greqjis					
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F		
VI	450	215	440	210	167	116	107	55	109	28	57	11	440	210	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	5	3.75
VII	443	219	434	216	144	107	70	50	117	41	96	15	427	213	98.00	0	0	0	7	3	7	3	2	1	7	2	3.56				
VIII	464	219	455	217	136	96	94	62	150	52	75	7	455	217	100	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	6	2	3.18			
IX	431	201	412	193	134	89	94	58	109	36	75	12	412	193	100	0	0	0	0	0	0	0	0	9	1	10	7	3.57			
VI-IX	1788	854	1741	836	581	408	365	223	485	155	303	47	1734	833	99.5	0	0	0	7	3	7	3	14	2	33	16	3.62				

## 6. Numri i nxënësve dhe suksezi në arsimin fillor dhe mesëm të ulët (I - V dhe VI – IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të viti shkollor 2023/24 ka qenë 3997 prej tyre 1910 femra, ndërsa kanë vijuar dhe janë vlerësuar me rezultat pozitiv 3899 ose 97.54 % dhe 7 apo 0.17 % kanë përsëritur apo nuk kanë treguar sukses të mjaftueshëm. Ndërkajq, nuk kanë vijuar, respektivisht të pa notuar kanë mbetur 91 prej tyre ose 2.27 %. Nëse e krahasojmë këtë numër të nxënësve me numrin e regjistruar një vit më parë (4119), atëherë del se gjatë këtij viti shkollor numri i nxënësve të regjistruar është më i vogël për 122 nxënës. Nota mesatare e këtyre dy niveleve është 3.87.

Rëndësi e vacantë, në këtë nivel arsimor, i është kushtuar zhvillimit të personalitetit, talentit dhe potencialit të plotë të aftësive mendore dhe fizike të nxënësit; të zhvillojë te nxënësi ndjenjën e respektit e të drejtave dhe lirisve themelore të njeriut, të zhvillojë te nxënësi ndjenjën e respektit për prindërit dhe mësuesit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e kombit të tij, përgatija e nxënësit për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e



mirëkuptimit, të paqes, të tolerancës, të barazisë gjinore, zhvillimit dhe thellimit të dijeve, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësive, aftësimi për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët/nxënësit të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi. Po ashtu, në këtë nivel, përmes Kurrikulës Bërthamë, nxënësit janë mbështetur të zhvillojnë shkathhtështë, qëndrimet dhe vlerat individuale në përputhje me kërkesat/nevojat e shoqërisë dhe duke kultivuar identitetin personal e duke zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetvetes dhe shoqërisë për jetë e punë. Ndërkaq, kujdes i veçantë në këtë nivel i është kushtuar fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore

Për më shumë shih Tabelën 3

Suksesit sipas klasave I – IX, në nivelin fillor dhe mesëm të ulët, vitit shkollor 2022 – 2023

Klasa	SUKSESI POZITIV														SUKSESI NEGATIV						TE PANOTUAR						Nota mesatare		
	Gj: nxenes		Vijojne		Shkelq.		Sh.mire		Mire		Mjart.		Gj.pozitiv		%	Me 1x1		Me 2x1		Me 3x1		Gj:negativ		Nuk vijojn Te greqjis					
	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F				
I	452	226	440	220	283	146	82	28	55	38	20	8	440	220	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	2	8	4	4.2
II	453	221	450	219	271	144	99	43	57	23	23	9	450	219	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2	4.13
III	428	189	417	188	229	119	83	31	83	31	22	7	417	188	100	0	0	0	0	0	0	0	0	4	0	7	1	4.09	
IV	436	216	425	214	207	127	98	44	79	27	41	16	425	214	100	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	10	2	4.02	
V	440	204	433	200	217	125	104	43	76	26	36	6	433	200	100	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	5	2	4.1	
L-V	2209	1056	2165	1041	1207	661	466	189	350	145	142	46	2165	1041	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	11	4	33	11	4.1
VI	450	215	440	210	167	116	107	55	109	28	57	11	440	210	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	5	3.75
VII	443	219	434	216	144	107	70	50	117	41	96	15	427	213	98.00	0	0	0	0	7	3	7	3	2	1	7	2	3.56	
VIII	464	219	455	217	136	96	94	62	150	52	75	7	455	217	100	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	6	2	3.18	
IX	431	201	412	193	134	89	94	58	109	36	75	12	412	193	100	0	0	0	0	0	0	0	0	9	1	10	7	3.57	
VI-IX	1788	854	1741	836	581	408	365	223	485	155	303	47	1734	833	99.5	0	0	0	0	7	3	7	3	3	14	2	33	16	3.62
L-IX	3997	1910	3906	1877	1788	1069	831	412	835	300	445	103	3899	1874	99.81	0	0	0	0	7	3	7	3	3	25	6	66	27	3.87

Suksesit e nxënësve sipas shkollave prezantohet përmes Tabelës Nr. 4

Nr. shkollës	gjitshëm nxënës		vëllojnë		SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV						Të Panourat		nota mesatare							
	Gj	F	Gj	F	shkëlq		shumë mirë		mirë		mjaft.		gjitshëm pozitiv		%	1x1		2x1		3x1		Gj negativ		nuk vëllojnë		Cregjistruar				
					Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj	F		Gj	F	Gj	F	Gj	F	Gj		F	Gj	F	Gj	F		
1 "E.D"	1315	631	1287	625	617	364	292	160	240	71	138	30	1287	625	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	22	5	6	1	4.03	
2 "K.Z"	395	183	363	173	147	84	74	44	97	36	45	9	363	173	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	32	10	3.8
3 "I.S"	448	219	445	218	218	125	97	51	88	35	42	7	445	218	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	1	0	0	4.08	
4 "J.G"	288	148	285	147	133	85	76	30	49	18	21	14	285	147	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	1	4.02	
5 "N.O"	298	139	298	139	137	82	53	20	77	33	31	4	298	139	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3.98
6 "Q.I"	406	187	398	185	176	111	86	38	80	23	49	10	391	182	98	0	0	0	0	7	3	7	3	0	0	0	8	2	3.82	
7 "A.A"	273	128	270	126	125	73	57	26	56	23	32	4	270	126	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2	3.89
8 "S.H"	240	120	238	119	113	71	24	12	55	20	46	16	238	119	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	1	3.79	
9 "G.L"	117	57	113	53	52	31	18	8	29	11	14	3	113	53	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	4	3.92	
10 "A.B"	155	66	155	66	49	30	38	16	48	17	20	3	155	66	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3.64
11 "D.U"	62	32	54	26	21	13	10	7	16	3	7	3	54	26	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8	6	3.63
Gjith	3997	1910	3906	1877	1788	1069	831	412	835	300	445	103	3899	1874	100	0	0	0	0	7	3	7	3	25	6	66	27	3.87		

**7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në nivelin fillor dhe mesëm të ulët**

Në dy nivelet arsimore, fillor dhe të mesëm të ulët (I – IX) gjatë këtij viti shkollor janë angazhuar gjithsej 345 mësimdhënës (173 femra) prej tyre 137 në mësimin klasor dhe 208 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë 344 apo shprehur në përqindje 99.71 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU në fund të vitit shkollor 2023/2024, kanë bërë gjithsej 95038 mungesa prej tyre 72474 të

arsyeshme, ose 18.3 orë për kokë nxënësi. Ndërkaj, mësimdhënësit gjatë këtij viti shkollor kanë humbur 1349 orë mësimore ose mesatarisht nga 3.91 orë për arsimtarë.

Komponentë mjaftë e rëndësishme është vijueshmëria e rregullt e nxënësve, por edhe e mësimdhënësve në mësim. Mosvijimi i rregullt në orët e mësimi ndikon negativisht në suksesin e nxënësve, ndërkohë që ky faktor merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së duhur në shkollë.

Arsyet janë të shumta për mosvijimin e rregullt të nxënësve në mësim, si: mungesa e motivimit, mosinteresimi i duhur i prindërve për ta, mësimdhënia joatraktive në disa lëndë mësimore, mbingarkesa e planeve dhe programeve mësimore, pastaj në shumë raste dhuna dhe presioni nga nxënësit problematikë, arsyet shëndetësore e plot e plot arsye të tjera. Së bashku herë nxënësit ikin nga orët e mësimi, kur nuk janë të përgatitur sa duhet për mësim, në ato lëndë që përgjithësisht i konsiderojnë si të rënda, apo mësimdhënësit kanë kritere të ashpër vlerësimi, duke preferuar më tepër të qëndrojnë larg shkollës, sesa të marrin nota negative. Jo rastësisht, nxënësit që bëjnë më tepër mungesa janë ata që kanë rezultate jo të mira në mësim. Këto dhe fakte tjera, janë shqetësuese, andaj edhe duhet të na obligojnë që të veprojmë më me ngulm dhe kompetencë duke zbatuar me përpikëri edhe masat edukative-disiplinore sipas Rregullores në fuqi.

Për më shumë informata shih Tabelën 5

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambytura të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në vitin shkollor

2023 – 2024

Nr.	Emri i shkollës	KUADRI ARSIMOR												mungesat e nxënësve		mes për nx.	orët e mbajtura arsimtar	për mesat arsimtar
		Mësimi Klasor			Mësimi lëndor			Dy ciklet			GJ	ARS.						
		Gj	F	Kv	%	Gj	F	Kv	%	GJ			F	Kv	%			
1	"Emin Duraku"	35	34	35	100	42	19	42	100	77	53	77	100	38595	29359	24.2	277	3.60
2	"Idriz Seferi"	18	12	18	100	23	9	23	100	41	21	41	100	12498	10219	27.8	170	4.14
3	"Kadri Zeka"	16	6	16	100	16	6	16	100	32	12	32	100	8696	6553	22	117	3.65
4	"Jusuf Gërvalla"	12	9	12	100	17	8	17	100	29	17	29	100	5618	4971	19.5	169	5.82
5	"Gamil Ilazi"	15	10	15	100	21	6	21	100	36	16	36	100	6019	4105	7.37	53	1.47
6	"Nazmi Osmani"	10	9	10	100	16	7	16	100	26	16	26	100	4658	4328	15.6	78	3
7	"Ali Asllani"	8	5	8	100	19	8	19	100	27	13	27	100	9251	8159	34.3	138	5.11
8	"7 Shtatori"	7	3	7	100	14	8	14	100	21	11	21	100	3579	83	14.1	51	2.42
9	"G.Luma"	6	2	6	100	11	3	11	100	17	5	17	100	1771	1530	15.67	44	0.71
10	"A.B."	5	3	5	100	13	3	13	100	18	6	18	100	3483	2509	22.5	162	9
11	"Dituria"	5	0	4	80	16	3	16	100	21	3	20	95.23	870	658	14	90	4.28
	Gjithsej	137	93	136	99.3	208	80	208	100	345	173	344	99.71	95038	72474	18.3	1349	3.91

## **8. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (AMLL)**

Edukimi dhe arsimimi në nivelin 3, AML-së në komunën tonë zhvillohet në 2 shkollat: në Gjimmazin “Skënderbeu” dhe IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Ky nivel arsimor ka për qëllim formimin e çdo individi, zhvillimin intelektual e social, kritik e krijues por edhe bashkëpunues në mënyrë që të përballoj dhe të jetë i gatshëm për sfidat e së ardhmes, ndërkaj që në këtë nivel merren hapat për të vazhduar me sukses, në tujë në studimet superiore.

### **8.1 Numri i nxënësve dhe suksesi në fund të vitit shkollor**

Në vitin shkollor 2023-2024 në dy shkollat e mesme janë regjistruan gjithsej 970 (523 mashkuj dhe 447 femra) prej tyre 564 në Gjimmazin “Skënderbeu” dhe 406 në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”.

Në kuadër të Gjimmazit “Skënderbeu” kanë funksionuar 2 drejtime: Shkenca Natyrore ( 4 paralele) dhe Shkenca Shogërore-Gjuhësore (3 paralele), ndërsa në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” kanë funksionuar 4 drejtime me 10 paralele:

1. Elektroteknikë me profilet: Teknik i Informatikës, Instalues Elektrikë dhe Elektronikë industriale me nga 1 paralele,
2. Ekonomi me profilet: Kontabilitet dhe Tatime dhe Tregti me Shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele.
3. Makineri me profilet: Instalues i ngrorhjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit me 2 paralele, Automekani dhe Metalpunues me nga 1 paralele dhe
4. Juridik me profilin: Nëpunës i administratës dhe shërbimeve të zyrës me 1 paralele.

Nëga gjithsej 970 nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2023 - 2024 (4 më pak krahasuar me vitin e kaluar shkollor kur ishin të regjistruar 974 nxënës), mësimin e kanë vijuar dhe janë vlerësuar gjithsej 896 nxënës, ndërsa rezultat pozitiv kanë treguar 891 prej tyre, ose 91.85 % e 5 nxënës të tjerë apo 0.51 % kanë mbetur me nota të dobëta (kanë përsëritur klasën në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”), dhe të pantohtar kanë mbetur 74 të tjerë ose 7.62 %.

Nota mesatare e nxënësve në të dy shkollat e mesme del 3.36, dhe atë në Gjimmazin “Skënderbeu” 3.88 e në IAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” 2.81.

Tabela Nr. 6  
 Suksesi i shkollave të mesme të larta në fund të vitit shkollor 2023 - 2024

Emri i shkollës	klasa	Të regjistruar		Vijojnë		SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV						TË PA NOTUAR				nota mesatare				
		Gj	F	GJ	F	Shkëlq.		Sh.mirë		Mirë		Mjaft.		Gjith pozitiv		%	1X1		1X2		Përsërisin me 3x1		Gjithsej negativ		Nuk vijojn gregjistr		Të			
						GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F		GJ	F	GJ	F	GJ	F	GJ	F						
"Skënderbeu"	X	177	117	169	113	54	39	55	42	53	28	7	4	169	113	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4	2	4	2	3.91
	XI	188	115	176	110	55	51	42	24	68	32	11	3	176	110	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6	3	6	2	3.76
	XII	199	133	190	132	77	65	54	40	46	24	13	3	190	132	100	0	0	0	0	0	0	0	0	4	1	5	0	3.98	
	X-XII	564	365	535	355	186	155	151	106	167	84	31	10	535	355	100	0	0	0	0	0	0	0	0	14	6	15	4	3.88	
	X	162	27	130	23	3	0	24	7	62	12	36	4	125	23	93	1	0	0	5	0	5	0	5	0	32	4	0	0	2.9
IAAP "F.G dhe v.Çaka"	XI	150	31	143	30	7	2	11	2	70	15	55	11	143	30	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7	1	0	0	2.78
	XII	94	24	88	23	4	1	11	4	38	10	34	8	88	23	100	0	0	0	0	0	0	0	0	6	1	0	0	2.75	
	X-XII	406	82	361	76	14	3	46	13	170	37	125	23	356	76	97	1	0	0	5	0	5	0	5	0	45	6	0	0	2.81
Gjithsej	970	447	896	431	200	158	197	119	337	121	131	33	891	431	99	1	0	0	5	0	5	0	5	0	59	10	15	4	3.35	

## **8.2 Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në nivelin e mesëm të lartë**

Në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 87 mësimdhënës, prej tyre 37 femra me kualifikueshmëri 100 % dhe atë 44 në Gjimnazin “Skënderbeu” e 43 në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”.

Një segment mjaft i rëndësishëm është edhe vijimi i rregullt i nxënësve e mësimdhënësve, ndërkaj janë bërë përpjekje maksimale për uljen në minimum të mungesave të tyre.

Në fund të këtij viti shkollor nxënësit e këtij nivelit të AML-së kanë bërë gjithsej 61292 mungesa, prej të cilave 43743 të arsyeshme ose 63.18 për kokë nxënësi.

Edhe numri i orëve të humbura është relativisht i lartë, ndërkaj kërkohet që të merren masa me qëllim të zvogëlimit në minimum të numrit të orëve të humbura mësimore. Mësimdhënësit e këtij niveli kanë humbur gjithsej 1018 orë mësimi apo 11.70 orë mësimi për një mësimdhënës.

Kualifikimi dhe ngritja profesionale, qasja e bazuar në kompetenca dhe rezultate është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor relevant për mësimdhënien e nxënies kualitative, dhe sigurinë të cilësisë, andaj edhe këtë vit shkollor i është kushtuar vëmendje e veçantë ngritjes dhe sigurimit të cilësisë.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7



Nr.	Emri i shkollës	KUADRI ARSIMOR				Mungesat e nx	Arsyeshme	Mesatarja për nxënës	Orët e humbura të arsimtarëve	Mesatarja për arsimtarë
		Gj	F	KV	%					
1	Skënderbeu	44	22	44	100	32325	24257	57.31	509	11.57
2	IAAP	43	15	43	100	28967	19487	71.34	509	11.83
	Gjithsej	87	37	87	100	61292	43744	63.18	1018	11.7

#### 9. Provimi i maturës dhe Testi i Arritshmërisë

Sikurse edhe viteve të mëhershme, edhe këtë vit 2023 -24, Testit të maturës i janë nënshtruar nxënësit maturantë të 2 shkollave të mesme, ndërsa në test janë përfshirë tri lëndë të obliguara (Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze dhe Matematikë) dhe një lëndë zgjedhore (që është zgjedhur nga vet nxënësit/kandidatët) nga lëndët zgjedhore në dispozicion, me gjithsej 100 pikë, nga secila lëndë me nga 25 pikë të mundshme.

Në afatin e parë të qershorit, të mbajtur më 22 qershor 2024, provimit të maturës iu janë nënshtruar gjithsej 218 maurantë prej tyre 194 nxënës të Gjimmazin “Skënderbeu” dhe 24 të tjerë të IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”, ndërsa atë e kanë kaluar 146 nxënës apo 66.97 %.

Në Gjimmazin “Skënderbeu” nga gjithsej 194 maturant, sa i janë nënshtruar testit të maturës, atë e kanë kaluar gjithsej 138 prej tyre, apo 71.13 %, ndërsa 56 maturantë, nuk kanë arritur pikët e mjaftueshme. Ndërkaq, në IAAP “Feriz Guri e vëllezërit Çaka”, nga 24 maturant/kandidatë që iu nënshtruar provimit të maturës 8 prej tyre e kanë kaluar apo 33.33% e 16 prej tyre nuk kanë fituar pikët e mjaftueshme apo nuk kanë arritur të kalojnë pragun prej 40 % nga 100 pikë të mundshme.

E në afatin e dytë të provimit të maturës, të mbajtur më 31 gusht 2024, në Gjimnazin “Skënderbeu” nga gjithsej 35 nxënës sa i janë nënshtruar testit të maturës, 23 prej tyre e kanë kaluar atë ose 65,71 %, ndërsa në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”, nga gjithsej 16 maturantë sa iu kanë nënshtruar testit, 9 prej tyre e kanë kaluar atë ose 56.25 %.

Gjatë këtij viti shkollor, në dy shkollat e mesme, kanë qenë të regjistruar gjithsej 293 nxënës maturant, ndërkaq mësimet i kanë vijuar 278 maturant, prej tyre 199 në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe 94 në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”.

Ndërkohë, nxënësit semimaturantë e kanë mbajtur Testin e Arritshmërisë 2024 dhe atë në dy pjesë, me gjithsej 200 pikë/kërkesa të mundshme Pjesa e parë është mbajtur më 25 qershor 2024 në lëndët: Gjuhë amtare (35 pikë/kërkesa), Gjuhë angleze (15 pikë/kërkesa), Histori (25 kërkesa/pikë) dhe Gjeografi (25 pikë/kërkesa) dhe Pjesa e dytë më 28 qershor 2024 në lëndët mësimore: Matematikë (35 pikë/kërkesa), Informatikë (15 pikë/kërkesa), Fizikë (17 pikë/kërkesa), Kimi (16 pikë/kërkesa) dhe Biologji (17 pikë/kërkesa). Nga rezultatet e dy testeve, nxënësit gjysëmaturantë të SHFMTU “Emin Duraku” në Kaçanik janë radhitur në vendin e tretë janë radhitur ata të SHFMTU “Idriz Seferi” në Bob me 47.59 efi, ndërsa në nivel të shkollave të Komunës përqindja e kalueshmërisë është 43.66 %.

Testi i Arritshmërisë ka për qëllim që t’i orientoj nxënësit në shkollimin e mëtejshëm në bazë të numrit të pikëve të fituara dhe arritja e rezultateve sa më të mira.

Kalueshmëria në përqindje dhe renditja e shkollave (nga viti 2016 e deri më 2024) është paraqitur në Tabelën Nr. 8

Emri i shkollës	2016, %	Renditja	2017, %	Renditja	2018, %	Renditja	2019, %	Renditja	2020	2021, %	Renditja	2022%	Renditja	2023%	Renditja	2024%	Renditja
1 Emin Duraku	60,08	4	51,59	2	58,69	2	56,37	2		52,04	2	49,74	3	45,67	7	49,12	1
2 Idriz Seferi	50,64	10	42,07	8	49,74	9	49,25	5		50,44	4	51,25	1	49,57	5	47,59	3
3 Kadri Zeka	58,57	6	38,93	10	57,82	3	38,75	10		50,81	3	40,58	8	52,14	2	44,79	5
4 Jusuf Gërvalla	59,48	5	46,72	3	56,28	4	51,43	4		47,3	6	43,14	6	53,84	1	44,08	7
5 Nazri Osmani	47,03	11	45,53	5	52,73	6	48,75	6		43,46	8	39,93	10	43,39	9	38,29	10
6 Qarull Iazi	53,30	9	52,18	1	52,09	7	53,58	3		58,8	1	50,73	2	46,74	6	42,96	8
7 Ali Aslani	54,34	8	45,84	4	39,13	12	44,11	7		40,67	9	44,91	5	44,86	8	48,02	2
8 Shtatori	64,25	1	54,31	6	40,07	10	38,67	11		39,64	10	40,09	9	50,12	3	44,36	6
9 Cafurr Luma	57,93	7	35,13	12	39,48	11	33,3	12		33,26	11	36,19	11	43,38	10	46,03	4
10 Agim Bajrami	60,55	3	39,90	9	50,54	8	59,11	1		46,92	7	42,39	7	49,64	4	40,36	9
11 Ditura	42,39	12	37,94	11	54,92	5	40	9		48,5	5	36,15	12	41,11	11	34,66	11
12 Naim Frashëri	60,83	2	42,11	7	62,62	1	40,6	8		/	/	46,75	/	/	/	/	/
Mes e shkoll	56,38 %		46,37%		52,70 %		49,84%			47,96%		43,48%		47,24%		43,66%	

Vërejtje: Testi i Aritshmërisë nuk është mbajtur në vitin 2020 për shkak të Pandemisë COVID 19.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipality of Kačanik

## Zyra e Kryetarit

01-Nr. 104/02-26072/24  
Kačanik, 11.10.2024

Në mbështetje të neneve 11, 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d) dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 043/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, nenin 33 të Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe duke patur parasysh Vendimin 01 Nr.060/01-23149/24 të datës 30.09.2024, kryetari i komunës, bënë këtë :

### Propozim

Që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës, të shqyrton dhe aprovon këtë:

### Vendim

Për plotësim ndryshim të Vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusave" sh.a- Kaçanik

#### I

Me këtë Vendim bëhet plotësim ndryshimi i pikës 2, paragrafi 2.1 i Vendimit **01Nr. 104/02-4209/22 i datës 28.02.2022** për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusave" sh.a-Kaçanik dhe atë anëtarë deritanishëm i këtij komisioni z. Rrustem Zenuni zëvendësohet me \_\_\_\_\_.

#### II

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Kuvendi komunal dhe kryetari i komunës.

#### III

Ky Vendim hynë në fuqi pas aprovimit në kuvend komunal.

#### IV

Me këtë Vendim do të njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, NPK "Stacioni i Autobusave" SH.A-Kaçanik dhe Arkiva.

## Arsyetim

Plotësim ndryshimi i pikës 2 paragrafi 2.1 i Vendimit **01Nr. 104/02-4209/22** i datës **28.02.2022** bazohet në Vendimin **01 Nr.060/01-23149/24** të datës **30.09.2024** për aprovimin e kërkesës për dorëheqjen e anëtarit të deritanishëm të këtij komisioni z. Rrustem Zenuni si dhe nevojës për vazhdimin e funksionimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusave" SH.A –Kaçanik i paraparë sipas nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 043/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

01 Nr. 104/02-4209/22  
Kaçanik, 28.02.2022

Në bazë të nenin 5 pika 2 e Ligjit Nr. 03L-/087 të Ndërmarrjeve Publike, të nenin (Gazeta Zyrtare Nr. 31/15 Qershor 2008) si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji, Ligji Nr. 04/L- 111 dhe Ligji Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 5, 12 pika 2(d) lidhur me nenin 17(f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 Shkurt 2022, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARVE PËR NPK**  
**"STACIONI I AUTOBUSVE " SH.A- KAÇANIK**

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale (NPK) "Stacioni i Autobusëve" Sh. A- Kaçanik.
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve", SH.A- Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi do të ketë 3 anëtarë: 1 (Një) anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës dhe 2 (dy) anëtarë emërohen nga Kuvendi i Komunës, në përbërje si vijon:

2.1 Rrustem Zenuni	anëtar	nga subjekti politik i PDK,
2.2 Ernesta Krasniqi	anëtar	nga subjekti politik i LVV,
2.3 Murat Burniku	anëtar	nga Ekzekutivi i Komunës.
3. Detyrat e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike si dhe në Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe Ndryshim Plotësimet e këtyre ligjeve dy ligjeve.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
6. Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-23149/24  
Kaçanik, 30.09.2024

Në bazë nenit 12.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), me Kërkesën e Rustem Zenuni 01Nr. 060/01-23149/24 për Dorëheqje nga Komisioni Komunal i Aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusëve" Sh. a. Kaçanik, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 30 shtator 2024, mori këtë:

#### VENDIM

#### PËR APROVIMIN E KËRKESËS 01NR. 060/01-23149/24 PËR DORËHEQJE TË RRUSTEM ZENUNI NGA KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE PËR NPK "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Kërkesa për Dorëheqje e anëtarit të KK, Rustem Zenuni 01Nr. 060/01-23149/24 e datës 16.09.2024 nga pozita e anëtarit të Komisionit Komunal i Aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusëve" Sh. a. Kaçanik.
2. Kërkesa për dorëheqje e anëtarit nga pika 1. e këtij vendimi, bëhet me vullneti e tij, për shkak të emërimit të tij, anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa.
3. Zëvendësimi i anëtarit të dorëhequr nga Komisioni Komunal i Aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusëve" Sh. a. Kaçanik, bëhet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me Ligjit Nr. 03L-/087 të Ndërmarrjeve Publike, si dhe Ndryshim Plotësimet e këtij Ligji.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Me këtë Vendim njoftohen: Rustem Zenuni, Kryetari i Komunës, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë), Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli





REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPSTINA KAÇANIK



Data	18.10.2024	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri	
		Shtojcë	
01-104/02-27046/24			



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRI OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. i Protokollit	DL	Nr. i Protokollit	6483-2/24
Nr. i Dokumentit	02	Data	17.10.24
PRISHTINË / A		Nr. 1	

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

HYRESE - UJAZNA - INCOMING	
REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT OF KOSOVO	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration	
17.10.2024	
Nr. i Lëndës	Vlera
-U1-	020-622/8

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Afrim Murati, UD. Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi - zyrtare ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi për miratimin e Planit të Veprimit në Mjedis me Veprim Klimatik i komunës së Kaçanikut 2024 -2029, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.09.2024

I nderuar kryetar Ilazi,  
I nderuar kryesues Murseli

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave ka pranuar nga MAPL Vendimin për miratimin e Planit të Veprimit në Mjedis me Veprim Klimatik i komunës së Kaçanikut 2024 -2029, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.09.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut:



## RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi për miratimin e Planit të Veprimit në Mjedis me Veprim Klimatik i komunës së Kaçanikut 2024 -2029, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut, datë 30.09.2024.

### ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të Vendimit të shënuar më lartë, konstatoi se:

- Plani hartohet për pesë vite andaj të mbetet 2025-2029 pasi tani jemi në fund të vitit 2024 kështu siç është hartuar i bie të jetë për gjashtë vite;
- Baza ligjore thirret në ligjin e kaluar për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, duhet të thirret në Ligjin e ri;
- Planit të realizimit të aktiviteteve u mungojnë vlerat e projekteve/aktiviteteve si dhe viti i realizimit.

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

